NËNSHKRUARJA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Teren; Z-Zyrt; O-Ortofoto; D-Matje Distancah.

PËRCAKTIMI I KUFITIT: P-Përditësim; P-Pronarë; SP-Strukturë e Pasurisë; T-Termin; V-Verdodhje e pasurisë.

SHËNIME TË VEÇANTA:
Matjet për realizimin e planrilevimit të sipërfaqes 18/142 dhe 18/15 nga specialisti Topograf, u bënë në vendndodhjen e kësaj pasurie me emërtimin Pusi Gazit Delvina 9, sipas evidencës dhe përcaktimit në terren të kufijve faktik të kësaj pasurie nga përfaqësuesit i QPN Fier (anëtar i strukturës) dhe anëtarët e strukturës së pasurisë. Ky proces po realizohet në zbatim të VKM Nr.28 Data 27.01.2023.

PRONARËT BASHKËPRONARËT/DEKLARIM MBI MARREDHËNIT ME KUFITARET

STRUKTURA E PASURISË	Kryetar	Anëtar
Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të pajisqishme të shoqërisë "Albpetrol" sh. a dhe pajesjen me përfaqësues pasurie të çdo pasurie të saj.	Dritan Shahu	Shkëlqim Kapllanaj
Udhëhiqur nr.120 datë 05.04.2024 i administratorit të shoqërisë "Albpetrol" sh. a me nr.2038 prn. datë 05.04.2024	Anëtar	Shpresa Pashaj
	Anëtar	Kleisi Xheferraj
	Anëtar	Reliana Varfi
	Anëtar	Andrian Pito
	Anëtar	Jorgjica Baba
	Anëtar	Dorian Capo

Kodet për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufitit:
T-Teren; Z-Zyrt; O-Ortofoto; KRIGJSH; ASIG; G-GPS; S-Station Total; D-Matje; Distancah; P-Përditësim; P-Pronarë; KP-Joqëndrues përfaqësues.

albpetroli
SHOQËRIA ALBPETROL SH.A
ADMINISTRATORI:
ELTAR DEDA
NËNSHKRUARJA



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE																														
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË		DATË: 18.09.2025		QËLLIMI: PËRDITËSIM/REGJISTRIM																										
VENDNDODHJA BASHKIA: DELVINË TË DHËNAT E PASURISË LLOJ I PASURISË: TRUALL (SIP PUS GAZI DELVINA 10 + SIP SHESH PAJISJE SPËRFAQËSORE)		ZONA KADASTRALE: 1464 / 2089		NR PASURISË: 18/724 2K1464 509/1 ; 509/2 ; 509 ZK 2089 SIP PAS 18/724 = 17818 m ² SIP PAS 509/1 = 2568 m ² SIP PAS 509/2 = 1150 m ² SIP PAS 509 = 17171 m ² SIP GJURMËS NDËRTIMT e : m ²		INDEX HARTE: DE-A-9, DE-B-9																								
Y(E)=509833.76 X(N)=4425591.81		KORRIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE			Y(E)=510026.67 X(N)=4425693.36																									
SHPJEGJESË Sipas gjendjes faktike		SH 1:1000																												
☐ SPËRFAQA TOTALE E TRUALLIT = 3500 m ²																														
Y(E)=509833.91 X(N)=4425592.71					Y(E)=510030.74 X(N)=4425693.36																									
NR	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TËPI I KUFITARIT	KUFITARI SPAS FAKTIT	ID/NPT	SHËNIME TË REALIZUESIT																								
1	VERI		Nr. pasurisë	-																										
2	JUG		Nr. pasurisë	Rrugë																										
3	LINDJE		Nr. pasurisë	-																										
4	PERËNDOM		Nr. pasurisë	Rrugë																										
REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT: EMRI: _____ LËCENCA NR: _____ DATE: ____/____/____ KOMPANIA: _____ NPTI: _____ NËNSHKRIMI/VULA: _____																														
REALIZOI PËR ASHK: SPECIALISTI: _____ DVASHK SARANDË: _____ NËNSHKRIMI: _____																														
KONFIRMOI: PËRQJEGJËSDREJTORI: _____ NËNSHKRIMI/VULA: _____																														
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; D-Matje Distancash. PËRCAKTIMI I KUFIRIT: P-Përfaqësues i Pronarëve; SP-Strukturë e Posaçme; T-Terren; V-Vendodhje e pasurisë. SHËNIME TË VEÇANTA: Matjet për realizimin e planrilevimit të sipërfaqes së pasurisë - nga specialisti Topograf, u bënë në vendndodhjen e kësaj pasurie me emërtimin Pusi Gazit Delvina 10, sipas evidentimit dhe përcaktimit në terren të kufijve faktik të kësaj pasurie nga përfaqësuesi i QPN Fier (anëtar i strukturës) dhe anëtarët e strukturës së posaçme. Ky proces po realizohet në zbatim të VKM Nr.28 Datë 27.01.2023. PRONARËT/BASHKËPRONARËT/DEKLARIM MBË MARRËDHËNIT ME KUFITARËT																														
STRUKTURA E POSAÇME Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të përcaktuara të shërbimit "Albpetrol" sh. a dhe pajisjen me certifikatë pasurie të çdo pasurie të saj. Undërtim nr.120 datë 05.04.2024 i administratorit të shërbimit "Albpetrol" sh.a me nr.2035 prot. datë 05.04.2024		<table border="1"><tr><td>Kryetar</td><td>Dritan Shahu</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Shkëlqim Kapllana</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Shpresa Pashaj</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Kleisi Xhaferaj</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Reliana Varfi</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Ardian Pilo</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Jorgjica Baba</td><td></td></tr><tr><td>Anëtar</td><td>Dorian Capo</td><td></td></tr></table>					Kryetar	Dritan Shahu		Anëtar	Shkëlqim Kapllana		Anëtar	Shpresa Pashaj		Anëtar	Kleisi Xhaferaj		Anëtar	Reliana Varfi		Anëtar	Ardian Pilo		Anëtar	Jorgjica Baba		Anëtar	Dorian Capo	
Kryetar	Dritan Shahu																													
Anëtar	Shkëlqim Kapllana																													
Anëtar	Shpresa Pashaj																													
Anëtar	Kleisi Xhaferaj																													
Anëtar	Reliana Varfi																													
Anëtar	Ardian Pilo																													
Anëtar	Jorgjica Baba																													
Anëtar	Dorian Capo																													
Kodet për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; KRGJSH; ASIG; G-GPS; S-Station Total; D-Matje; Distancash; P-Përfaq. i Pronarëve; KP-Kufitarët pjesërisht.																														



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË DATË: 18.09.2025 QËLLIMI: PËRDITËSIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA: BASHKIA DELVINE DVASHK: SARANDË ZONË KADASTRALE: 1484 NR. PASURISË: 18/131 INDEX HARTE: DE-E-10

TE DHËNAT E PASURISË: LLOJ I PASURISË: TRUALL (SIP. PUS. GJAZ DELVINA 12 + SIP. SHESH PAJISJE SIPËRFAQËSORE) SIP. PASURISË = 2782m² SIP. GJURMËS NDËRTIMIT = 9.2 m² NR. KATEVE: -

YE=510272.69 XN=442305.90 **KORRIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** YE=510468.55 XN=4423975.55

SH 1:1000

YE=510272.69 XN=442305.90 YE=510468.55 XN=4423975.55

NR.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI I KUFITARET	KUFITARI SIPAS FAKTIT	ID/MPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1	VERI		Nr. pasurisë	18/86		
2	JUG		Nr. pasurisë	18/126		
3	LINDJE		Nr. pasurisë	18/86		
4	PERENDW		Nr. pasurisë	18/86		

REALIZOI PËR SUBLJEKT PRIVAT:
EMRI: _____
LICENCA NR. _____ DATE: ____/____/____
KOMPANGA: _____
NPTI: _____
NËNDSHKRIMVULA: _____

REALIZOI PËR ASHK:
SPECIALISTI: _____
DVASHK SARANDË: _____
NËNDSHKRIMVULA: _____

KONFIRMOI:
PËRQJEGJËSORITORI: _____
NËNDSHKRIMVULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren; Z-Zyri; O-Orlolo; D-Matje Distanca; SH, P-Përfaqësues i Pronarëve; SP-Strukturë e Posaçme; T-Terren; V-Vendodhje e pasurisë.

PËRCAKTIMI I KUFITARET:
Matjet për realizimin e planrilevimit të sipërfaqes së pasurisë 18/131 nga specialisti Topograf, u bënë në vendndodhjen e kësaj pasurie me emërtimin Pusl Gazit Delvina 12, sipas evidentimit dhe përcaktimit në terren të kufijve faktik të kësaj pasurie nga përfaqësuesi i QPN Fier (anëtar i strukturës) dhe anëtarit të strukturës së posaçme. Ky proces po realizohet në zbatim të VKM Nr.28 Date 27.01.2023.

SHËNIME TË VEÇANTA:

PRONARËT BASHKËPRONARËT/DEKLARIM MBI MARRËDHËNIT ME KUFITARËT

STRUKTURA E POSAÇME	Kryetar	Anëtar
Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të palopshme të shoqërisë "Albpetrol" sh. a dhe pajson me certifikatë pasurie të qdo pasurie të saj.	Dritan Shahu	Shkëlqim Kapllanaj
Udhëtar nr.120 datë 05.04.2024 i administratit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a me nr.2038 prot. datë 05.04.2024	Anëtar	Shpresa Pashaj
	Anëtar	Klausi Xhaferaj
	Anëtar	Reliana Varfi
	Anëtar	Ardian Pilo
	Anëtar	Jorgjica Baba
	Anëtar	Dorian Capo

Kodet për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufitit:
T-Terren; Z-Zyri; O-Orlolo; KRCUSH; ASIG; G-GPS; S-Station Total; D-Matje; Distanca; P-Përfaq; i Pronarëve; KP-Kompani përditësim.

SHOQËRIA ALBPETROL SH.A

ADMINISTRATORI
ELTAR DEDA
 NËNDSHKRIMVULA: _____



VENDIM
Nr. 532, datë 9.7.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të

Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të dhënat kadastrale të pronës me numër rendor 85, me emërtimin “Reparti 1300 ish-Shtabi i Xhenios”, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara sipas formularit të inventarizimit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe planit të rilevimit, gjithsej 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror: Ministria e Mbrojtjes				Identifikoi:		ELIDA LEKA (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		FINANCIERE		682249331		
				Supervizoi:		Nimet Luli (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Menaxher Hoteli				
				Aprovoi:		Eduart Spahiu (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)		Drejtor i SHQFA				
Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronës	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)					
85	8110	3/129	Truall Ndertese	Reparti 1300 Ish Shtabi i Xhenjos Rruga Rexhep Tarja	4210		1331.3	Hotel zyra	Ministria e Mbrojtjes	SHQFA	NR. 515 18.7.2003	

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për prona me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																	
Prona nr.85 "Shtepia Qendrore e Forcave te Armatosura" , Tiranë																																	
PRONARI :SHTET		DATE <u>15/12/2025</u>	QËLLIMI <u>PËRDITËSIM</u>																														
VENDNDODHJA																																	
Bashkia TIRANË DVASHK TIRANA VERI		Nr.Pasurisë <u>3/129;</u>	Z.K8110 Indeksi i Hartës TR-F-17																														
TE DHËNAT E PASURISË																																	
Lloi i pasurisë _____	Sip e pasurisë 5135m²	Sip e gjurmës së ndërtimit 1362m ²	Nr. kateve _____																														
Nord = 4579861.04 East = 487217.54		Nord = 4579861.52 East = 487363.87																															
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)																																	
SHPJEGUES SIPËRFAQE E PËRGJITHSHME E PRONËS SIPAS FAKTIT. =4210 m2 SIPËRFAQE E GJURMËS SË NDËRTIMIT. =1331.3 m2 NDËRTIME INFORMALE Nord = 4579744.52 East = 487217.23 SH 1: 1000 METRA Nord = 4579861.52 East = 4579861.52																																	
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>NR</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI I KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ven</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>K51726024H</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perendim</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	1	Ven				K51726024H	2	Lindje					3	Jug					4	Perendim				
NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT																												
1	Ven				K51726024H																												
2	Lindje																																
3	Jug																																
4	Perendim																																
REALIZOI PËR IGJIU Ing.Eris Ndrukaj KONFIRMOI PËR IGJIU DREJTORI Jurgjen ÇOLAKU		TEKNOLOGJIA E MATJEVE GPS ; O-Ortofoto. PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas matjeve në terren ,HTR-s SHËNIME TË VEÇANTA:Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Sekretarit të shtetit nr.5898, datë 15.10.2025, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor. Shënim: Kabina elektrike e paraqitur në planin e rilevimit me ngjyrë të verdhë në anën veriore të pronës është në favor të OSHEE dhe nuk është përfshirë në sipërfaqen e pronës.																															
REALIZOI PËR ASHK Specialisti _____ DVASHK _____ Nënshkrimi _____ KONFIRMOI Përgjegjësi/Drejtori _____ Nënshkrimi/ Vula _____		PRONARI:SHTET MIRATOHET DREJTORI I SHOFA Eduart SPAHIU																															



VENDIM

Nr. 533, datë 9.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR
GJURMUESHMËRINË, RREGULLAVE
PËR ELEMENTET, ETIKETËN APO
PULLËN UNIKE TË MARKIMIT APO
FORMA TË TJERA TË IDENTIFIKIMIT
E TË INDIVIDUALIZIMIT TË
ARMATIMIT USHTARAK,
PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË
MARKIMIT DHE GJURMIMIT, SI DHE
AUTORITETIT APO PALËS SË
AUTORIZUAR PËR REALIZIMIN E
MARKIMIT E TË GJURMIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kërkesave për gjurmueshmërinë dhe i rregullave për markimin, përfshirë etiketën, pullën unike dhe format e tjera të identifikimit dhe individualizimit të armatimit ushtarak, si dhe i procedurës e mënyrës së markimit dhe gjurmimit dhe i autoritetit përgjegjës për realizimin e mbikëqyrjen e këtij procesi.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është krijimi dhe funksionimi i një sistemi të harmonizuar e të kontrollueshëm për markimin dhe gjurmimin e armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe të teknologjive ushtarake, për:

a) parandalimin e përdorimit të paautorizuar ose të paligjshëm të armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe të teknologjive ushtarake;

b) standardizimin e elementeve të etiketës, të pullës unike, ose të formave të tjera të individualizimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake;

c) lehtësimin e gjurmueshmërisë nga autoritetet ligjzbatuese;

ç) verifikimin e ligjshmërisë së origjinës e të pronësisë;

d) gjurmimin e loteve specifike të prodhimit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Deklarata e transportit”**, dokumenti shoqërues i mallrave gjatë transportit, i cili përmban të dhënat identifikuese të ngarkesës, të palëve të përfshira, të mjetit të transportit e të destinacionit dhe që shërben për qëllime të gjurmimit, të kontrollit e të verifikimit nga autoritetet kompetente;

2. **“Etiketa”**, shenjë identifikuese fizike, e vendosur nga subjekti i licencuar mbi armët, municionet, pajisjet dhe teknologjitë ushtarake, që përmban të dhëna të dukshme e të lexueshme dhe shërben për të garantuar origjinalitetin, gjurmueshmërinë e përputhshmërinë me standardet ligjore dhe të sigurisë;

3. **“Etiketimi”**, procesi i vendosjes së etiketës ose së pullës unike mbi armët, municionet, pajisjet dhe teknologjitë ushtarake ose mbi paketimin e tyre, me qëllim identifikimin e gjurmimit. Etiketimi përbën një nga format e realizimit të markimit;

4. **“Identifikimi me frekuencë radioje (RFID)”**, një teknologji që përdoret për identifikimin e gjurmimit automatik të objekteve nëpërmjet valëve elektromagnetike;

5. **“Kodi unik alfanumerik”**, numri serial unik, i cili gdhendet ose stampohet në mënyrë të përhershme në trupin e armës, të pajisjes e të teknologjive ushtarake. Stampimi bëhet në formë etikete ose pulle;

6. **“Markimi”**, procesi i vendosjes së një shenje unike identifikuese në formë kodi, pulle, etikete ose çdo forme tjetër identifikimi dhe individualizimi në armatimin ushtarak, nënproduktet ose produktet përfundimtare të tij, me qëllim identifikimin e gjurmimit e tyre, në përputhje me përcaktimin e ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit,



tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”;

7. **“Pulla unike”**, shenjë identifikuese elektronike, e vendosur nga subjekti i licencuar për armët, municionet, pajisjet e teknologjisë ushtarake dhe shërben për të garantuar origjinalitetin, gjurmueshmërinë e përputhshmërinë me standardet ligjore dhe të sigurisë;

8. **“Regjistri elektronik”**, sistemi elektronik i administruar nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, në të cilin subjektet e licencuara duhet të hedhin të dhënat, që bëjnë të mundur identifikimin dhe gjurmimin e armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe të teknologjive ushtarake;

9. **“Specifikimet teknike”** përfaqësojnë një kuadër teknik detyrues, që përcakton mënyrën, elementet identifikuese të nevojshme për të siguruar identifikimin, kontrollin, gjurmueshmërinë dhe parandalimin e përdorimit të paautorizuar të këtyre produkteve;

10. **“Standardet ndërkombëtare”**, dokumente të hartuara nga organizata ndërkombëtare të standardizimit, si ISO, që përcaktojnë rregulla, udhëzime, ose karakteristika për produkte, procese ose shërbime, me qëllim që të sigurohet cilësia, siguria dhe efikasiteti në tregjet ndërkombëtare, dhe që publikohen në nivel kombëtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit si standarde shqiptare.

11. **“Uniformat”**, veshje të disanjuara posaçërisht për përdorim nga Forcat e Armatosura ose nga institucionet e sigurisë.

KREU II PROCEDURA E GJURIMIT DHE REGJISTRI ELEKTRONIK

Neni 4 Procedura e gjurmimit

1. Gjurmimi i çdo njësie armësh, municioni apo pajisjeje ushtarake realizohet nëpërmjet regjistrit elektronik dhe sistemit të gjurmimit të subjekteve të licencuara, të cilat mbulojnë të gjitha fazat e ciklit të jetës së produktit, përfshirë prodhimin, regjistrimin fillestar të gjendjes, magazinimin, transportin, shpërndarjen, përdorimin e asgjësimit.

2. Regjistri elektronik dhe sistemi i gjurmimit regjistrojnë në mënyrë të automatizuar e të menjëhershme çdo regjistrim fillestar të gjendjes,

çdo transaksion, ndryshim pronësie, transferim apo modifikim statusi të njërive të regjistruara, duke garantuar integritetin, pandryshueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave.

3. Regjistri elektronik dhe sistemi i gjurmimit mundësojnë gjenerimin e raporteve të personalizuar sipas periudhave kohore, llojit të produktit, subjektit të përfshirë apo fazës së ciklit të jetës, duke përfshirë grafikë të lëvizjes dhe sinjalizime për devijime nga itineraret apo procedurat e autorizuar.

Neni 5 Regjistri elektronik i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

Regjistri elektronik i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes përmban, të paktën, këto të dhëna dhe funksione:

a) Regjistrimin unik dhe të detajuar të çdo njësie armësh, municioni apo pajisjeje ushtarake, përmes një identifikuesi të veçantë, që përfshin të dhëna, si: emri ose kodi i prodhuesit, numri serial, vendi dhe data e prodhimit, si dhe klasifikimi ushtarak i produktit;

b) Ndërlidhjen me sistemet e subjektit të licencuar për hedhjen e të dhënave për identifikimin dhe gjurmimin e armëve;

c) Gjenerimin e raporteve periodike dhe analitike mbi sasinë, itineraret, devijimet, përdorimin dhe ngjarjet kritike, në funksion të kontrollit dhe transparencës së aktivitetit të prodhimit të industrisë ushtarake;

ç) Sinjalizimin automatik të manipulimit të paautorizuar, apo shkëljes së procedurave të sigurisë nëpërmjet aktivizimit të alarmeve dhe njoftimit të menjëhershëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes;

d) Ruajtjen e kopjeve rezervë (*backup*) të të dhënave në mënyrë të sigurt e të verifikueshme.

Neni 6 Sistemi elektronik i gjurmimit për subjektet e licencuara

1. Çdo subjekt i licencuar është i detyruar të krijojë dhe të përdorë një platformë të brendshme elektronike për gjurmimin e regjistrimin e produkteve që trajton, në përputhje me kërkesat



teknike të përcaktuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

2. Sistemi elektronik i gjurmimit i ngritur nga subjekti duhet të përmbushë funksionet kryesore të mëposhtme:

a) Regjistrimin unik dhe të detajuar të çdo njësie armësh, municionesh, pajisjesh dhe teknologjish ushtarake nëpërmjet një identifikuesi të veçantë, që përfshin: emrin e prodhuesit, numrin serial, vendin dhe datën e prodhimit, si dhe klasifikimin ushtarak;

b) Verifikimin në kohë reale të gjendjes e të lëvizjes së njërive të regjistruara nëpërmjet integritetit me pajisje të gjurmimit elektronik dhe sisteme të tjera të mbikëqyrjes;

c) Gjenerimin e raporteve periodike dhe analitike mbi sasinë, itineraret, devijimet, përdorimin dhe ngjarjet kritike;

ç) Sinjalizimin automatik të çdo devijimi nga itinerari i autorizuar, manipulimi i paautorizuar apo shkelje të procedurave të sigurisë nëpërmjet aktivizimit të alarmeve dhe njoftimit të menjëhershëm të strukturave të brendshme të sigurisë dhe të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes;

d) Ndërlidhjen me regjistrin elektronik të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes;

dh) Sigurimin e integritetit e të mbrojtjes së të dhënave, sistemeve dhe rrjeteve digjitale, në përputhje me legjislacionin për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

e) Ruajtjen e kopjeve rezervë (*backup*) të të dhënave në mënyrë të sigurt e të verifikueshme.

3. Subjekti i licencuar është përgjegjës për mirëmbajtjen, përditësimin dhe auditimin periodik të platformës së tij të gjurmimit, si dhe për sigurimin e aksesit të autorizuar të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes për qëllime inspektimi dhe kontrolli.

Neni 7

Regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave

1. Subjektet e licencuara janë të detyruara të regjistrojnë dhe të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat për çdo njësi armësh, municionesh, pajisjesh dhe teknologjish ushtarake, për të cilën mbajnë përgjegjësi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

2. Regjistrimi përfshin të dhëna të detajuara për identifikimin e gjurmimit e çdo njësie, përfshirë: emrin e prodhuesit, numrin serial, datën dhe vendin

e prodhimit, llojin dhe kalibrin, lotin e prodhimit, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për qëllime sigurie dhe transparence.

3. Subjektet janë përgjegjëse për saktësinë, përditësimin e përputhshmërinë e të dhënave të regjistruara me aktivitetin real të tyre, si dhe për sigurimin e aksesit të autorizuar të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes për qëllime inspektimi dhe kontrolli.

4. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes administron dhe ruan të dhënat e dërguara nga subjektet, pa ndërhyrë në përmbajtjen e tyre, duke garantuar integritetin, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e informacionit të regjistruar.

Neni 8

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave

1. Të dhënat që lidhen me procesin e markimit dhe gjurmimit të armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake ruhen nga subjektet e licencuara për një periudhë jo më pak se dhjetë (10) vjet nga data e regjistrimit të tyre.

2. Subjektet e licencuara janë të detyruara të mbajnë kopje rezervë të të dhënave të regjistruara dhe të raportojnë menjëherë çdo ndryshim, përditësim apo pasaktësi në informacionin e depozituar në sistem.

3. Administrimi i të dhënave në regjistrin elektronik kryhet nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.

KREU III

MARKIMI DHE ELEMENTET E IDENTIFIKIMIT

Neni 9

Kriteret e përgjithshme të markimit

1. Markimi i armëve, i municioneve, i pajisjeve dhe i teknologjive ushtarake kryhet në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në këtë vendim.

2. Markimi plotëson kushtet e parashikuara, si më poshtë vijon:

a) qëndrueshmëri fizike dhe kimike ndaj kushteve të përdorimit;

b) lexueshmëri në çdo moment gjatë ciklit të jetës së produktit;



c) siguri kundër manipulimit, fshirjes, falsifikimit apo ndërhyrjeve të paautorizuara;

ç) integrim me sistemet elektronike të gjurmimit.

3. Markimi realizohet në sipërfaqe të dukshme dhe në vende të përcaktuara teknikisht nga ky vendim, si dhe të jetë i përhershëm.

Neni 10

Detyrimet sipas llojit të subjektit të licencuar

1. Subjektet e licencuara për prodhimin janë të detyruara:

a) të kryejnë markimin e produkteve përpara daljes nga mjedisi i prodhimit;

b) të vendosin identifikuesit sipas këtij vendimi;

c) të regjistrojnë të dhënat në sistemin elektronik të gjurmimit.

2. Subjektet e licencuara për importin janë të detyruara:

a) të importojnë vetëm produkte të markuara sipas këtij vendimi ose standardeve ndërkombëtare;

b) të verifikojnë përputhjen e markimit me kërkesat e këtij vendimi;

c) të regjistrojnë produktet në sistemin elektronik përpara hedhjes në treg.

3. Në rast se produktet e importuara nuk përmbushin kërkesat e markimit, subjekti importues është i detyruar të sigurojë plotësimin e tyre përpara tregtimit ose përdorimit.

Neni 11

Mënyra dhe metodat për qëndrueshmërinë e markimit

1. Markimi realizohet nëpërmjet:

a) gdhendjes mekanike;

b) gravurës me lazer;

c) stampimit mekanik;

ç) etiketimit me barkode, *QR code* ose mikroçipa RFID.

2. Markimi duhet të jetë rezistent ndaj konsumimit mekanik gjatë përdorimit, mirëmbajtjes, apo transportit.

3. Markimi duhet të ruajë integritetin pas ekspozimit ndaj agjentëve atmosferikë dhe korrozionin kimik.

4. Markimi duhet të realizohet nëpërmjet përdorimit të barkodeve, *QR code* dhe mikroçipave

RFID për skanim të shpejtë, ruajtje të informacionit dhe gjurmim në kohë reale me lexim automatik.

5. Markimi duhet të jetë i lexueshëm, i qartë dhe i dallueshëm me sy të lirë. Në rastet kur markimi kryhet me teknologji elektronike, sigurohet që të jetë i lexueshëm nëpërmjet pajisjeve të standardizuara të skanimit.

6. Markimi duhet të aplikohet në sipërfaqe të aksesueshme, që mundësojnë verifikim të menjëhershëm, përfshirë trupin kryesor të produktit, pjesët mekanike funksionale ose sipërfaqe të tjera të përshtatshme.

7. Markimi duhet të jetë i qëndrueshëm, duke u realizuar me teknika, që garantojnë rezistencë afatgjatë ndaj konsumit, dëmtimeve mekanike, si dhe ndikimeve atmosferike e kimike, me qëllim ruajtjen e lexueshmërisë gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit.

Neni 12

Koha dhe vendosja e markimit

Markimi kryhet:

a) në prodhim – përpara daljes së produktit nga mjedisi i prodhimit, në paketim dhe në dorëzim;

b) në import – përpara hedhjes në treg ose përdorimit;

c) pas riparimit ose modifikimit – kur preket identifikimi.

Neni 13

Elementet e specifikimeve teknike për markimin e armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe teknologjive ushtarake

Specifikimet teknike për markimin e armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe teknologjive ushtarake janë, si më poshtë vijon:

a) Prodhuesi – emri ose kodi unik i prodhuesit, që identifikon subjektin përgjegjës për prodhimin;

b) Numri serial – numër serial unik (numerik ose alfanumerik), që garanton individualizimin e papërsëritshëm të çdo njësie; numri nuk mund të kopjohet, të ndryshohet apo të ripërdoret për njësi të tjera;

c) Viti i prodhimit – viti i prodhimit i shënuar me katër shifra;

ç) Vendi i prodhimit – shteti ose vendi, ku është prodhuar njësia;



d) Modeli dhe, kur është e zbatueshme, kalibri i armës ose i municionit.

Neni 14

Procedura e markimit dhe e regjistrimit

1. Markimi i armëve, i municioneve, i pajisjeve dhe i teknologjive ushtarake kryhet në fazën e prodhimit për çdo njësi të prodhuar brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë vendim.

2. Çdo njësi, që i nënshtrohet markimit, regjistrohet në sistemin elektronik të gjurmimit të subjektit të licencuar dhe në regjistrin elektronik të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

3. Të dhënat e markimit përditësohen në regjistrin elektronik në çdo rast transferimi, riparimi, ndryshimi statusi ose asgjësimi të njësisë së markuar.

Neni 15

Të dhënat e detyrueshme dhe forma e markimit

1. Gdhendja mekanike, gravura me lazer, stampimi mekanik, etiketimi me barkod, si formë markimi, përfshijnë:

- a) numrin serial unik;
- b) emrin ose kodin e prodhuesit;
- c) vendin e prodhimit;
- d) modelin dhe kalibrin e armës;
- e) vitin e prodhimit.

2. Gdhendja realizohet në mënyrë të qartë, të lexueshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me kërkesat e specifikuara në këtë vendim.

3. Gravura realizohet me thellësi dhe cilësi në mënyrë që të garantojë lexueshmërinë afatgjatë dhe të mos dëmtohet nga përdorimi normal i produktit ushtarak.

4. Stampimi të jetë i qëndrueshëm, i padëmtueshëm nga faktorët e jashtëm dhe i verifikueshëm nëpërmjet inspektimit vizual ose mjeteve të thjeshta të kontrollit.

5. Etiketa me barkod vendoset në sipërfaqe të dukshme dhe të aksesueshme për skanim, është e qëndrueshme ndaj konsumit, gërryerjes dhe kushteve atmosferike.

Neni 16

Etiketa dhe pulla

1. Çdo produkt ushtarak pajiset me një etiketë ose pullë me kod identifikues.

2. Etiketa ose pulla përmban të paktën:

a) kodin unik alfanumerik (me minimum 12 karaktere);

b) datën dhe vendin e prodhimit;

c) të dhëna mbi prodhuesin;

ç) simbolin ose logon e prodhuesit të certifikuar.

3. Llojet e etiketës ose të pullës janë, si më poshtë:

a) Fizike, e aplikuar në sipërfaqe të qëndrueshme të produktit nëpërmjet gravurës, stampimit mekanik ose ngjitjes;

b) Elektronike, nëpërmjet teknologjive *QR code*, *Data Matrix*, RFID ose NFC, me përmbajtje të barasvlershme me etiketën fizike.

4. Etiketa ose pulla duhet të jetë rezistente ndaj lagështisë, ndryshimeve të temperaturës dhe ndërhyrjeve të jashtme, duke garantuar lexueshmëri dhe integritet gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit.

5. Etiketimi fizik ose elektronik kryhet përpara dorëzimit të produktit te porositësi dhe përpara se ai të largohet nga mjedisi i prodhimit. Vendosja ose përsëritja e etiketimit është e detyrueshme pas çdo ndërhyrjeje teknike, si: riparimi, riciklimi apo përpunimi i produktit.

Neni 17

Etiketimi i armëve, i pajisjeve dhe i teknologjive ushtarake

Çdo armë, pajisje dhe teknologji, që prodhohet, importohet, tregtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë e pajisur me një etiketë ose pullë unike identifikuese, të vendosur në mënyrë të dukshme e të qëndrueshme në trupin e armës, sipas specifikimeve në nenin 16 të këtij vendimi.

Neni 18

Etiketimi i municioneve

1. Etiketimi i municioneve realizohet në dy nivele:

a) në nivel paketimi nëpërmjet vendosjes së shenjave identifikuese në kutitë e jashtme;

b) në nivel njësie individuale (fishek), kur kërkohet nga natyra e përdorimit ose rregulloret teknike.



2. Paketimi i municioneve duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:

- a) Emrin e prodhuesit;
- b) Llojin dhe kalibrin e municionit;
- c) Lotin e prodhimit (*batch/lot number*);
- ç) Datën e prodhimit;
- d) Kodin unik për gjurmim (barkod, *QR code* ose numër serial për kuti);

dh) Të dhënat e prodhimit për llojin e lëndës shtytëse (barutit) dhe të lëndës plasëse, që ka predha.

3. Barkodet dhe *QR code* vendosen në paketim për lexim me skaner dhe lidhen me të dhëna, si: data e prodhimit, loti, kalibri dhe destinacioni, duke u përdorur për qëllime regjistrimi, transporti, magazinimi dhe shpërndarjeje.

4. Në nivel njësie individuale, kur kërkohet nga natyra e përdorimit ose rregulloret:

a) maja e plumbave markohet me kodim me ngjyra për të dalluar llojet e municionit (penetrues, gjurmëlënës, shpërthyes), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e partnerëve strategjikë;

b) për të mundësuar identifikimin, përdoret teknika e mikrokodimit, e cila lejon gdhendjen e kodeve mikroskopike unike në kapsolla ose në trupin e fishekut, individual të municionit.

KREU IV MARKIMI DHE GJURMIMI NË TRANSPORT DHE PËR UNIFORMAT

Neni 19

Kërkesat për transportin e armatimeve, municioneve dhe teknologjive ushtarake

1. Çdo njësi armatimi, municioni apo teknologjie ushtarake e destinuar për transport duhet të jetë e pajisur me markim të qartë, të qëndrueshëm dhe të lexueshëm, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme.

2. Markimi duhet të përfshijë të paktën:

- a) emrin ose kodin e prodhuesit;
- b) numrin serial unik;
- c) vendin dhe datën e prodhimit;
- ç) kodin e lotit të prodhimit;
- d) kodin e eksportit dhe destinacionin përfundimtar.

3. Produktet e eksportuara duhet të jenë të regjistruara në regjistrin elektronik, përpara daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke

përfshirë të dhënat e transportit, subjektin eksportues dhe marrësin përfundimtar.

4. Subjektet e licencuara për importin ose eksportin e armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe të teknologjive ushtarake importojnë ose eksportojnë vetëm produkte të markuara, në përputhje me këtë vendim ose me standardet ndërkombëtare të zbatueshme. Shenjat unike të identifikimit regjistrohen në sistemin e gjurmimit të subjektit dhe në regjistrin elektronik të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes përpara hyrjes ose daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Etiketimi dhe dokumentacioni për transport

1. Çdo njësi e transportuar duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës të identifikimit e të gjurmimit, përfshirë:

- a) certifikatën e origjinës;
- b) deklaratën e transportit;
- c) etiketat e transportit dhe të sigurisë, sipas standardeve të NATO-s.

2. Në rastet kur produktet përmbajnë mallra të rrezikshme, etiketimi dhe paketimi duhet të jenë në përputhje me Konventën SOLAS, ratifikuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947”, të ndryshuar, dhe në protokollin e kësaj Konvente, të vitit 1978, të ndryshuar”, dhe me Kodin IMDG të zbatueshëm në kuadër të saj, për të garantuar sigurinë gjatë transportit ndërkombëtar.

3. Kërkesat e këtij vendimi për markimin e gjurmimit zbatohen për produktet e prodhuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për produktet e importuara. Subjektet e licencuara për importin janë përgjegjëse për verifikimin dhe regjistrimin e markimit të produkteve të importuara përpara shpërndarjes ose përdorimit të tyre.

Neni 21

Markimi i uniformave

1. Markimi i uniformave realizohet në nivel njësie nëpërmjet vendosjes së etiketës ose të pullës identifikuese.



2. Markimi realizohet në formë fizike ose elektronike, përfshirë barkodet, *QR code* ose teknologji të tjera të lexueshme elektronikisht.

3. Markimi vendoset në mënyrë të qëndrueshme në produkt dhe duhet të jetë i lexueshëm gjatë gjithë ciklit të përdorimit.

Neni 22

Etiketimi i uniformave

1. Etiketa ose pulla për uniformat përmban, të paktën:

- a) kodin unik të lotit;
- b) emrin ose kodin e prodhuesit;
- c) datën e prodhimit;
- ç) vendin e prodhimit.

2. Etiketa paraqitet në formë të qartë dhe të standardizuar, duke mundësuar identifikimin e leximin e menjëhershëm të të dhënave.

3. Etiketa mund të jetë në formë fizike, e qepur, e stampuar ose e ngjitur në produkt, ose në formë elektronike, nëpërmjet barkodit, *QR code* ose teknologjive të tjera të lexueshme elektronikisht.

Neni 23

Gjurmimi i uniformave

1. Gjurmimi i uniformave realizohet nëpërmjet kodit unik të lotit të vendosur në etiketë.

2. Çdo lot uniformash pajiset me një kod unik identifikues, i cili regjistrohet në sistemin elektronik të gjurmimit.

3. Të gjitha uniformat, që i përkasin të njëjtit lot, identifikohen nëpërmjet këtij kodi dhe gjurmohen në mënyrë të përbashkët.

4. Regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave kryhen në përputhje me kreun II të këtij vendimi.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA I

FORMATI I ETIKETËS

(Në zbatim të neneve 12, 15 dhe 16)

1. Emri i markës/kompanisë:

Shembull: ALFA sh.p.k.

2. Logoja (nëse ka):

Vendoset sipër ose në cep në të majtë.

3. Numri serik unik (për çdo produkt):

Shembull: SN: 001294837B

4. *QR code*/Barcode

Lidhet me sistemin e verifikimit *online* ose informacion shtesë rreth produktit.

5. Vendi i prodhimit/data e prodhimit:

Shembull: *Made in Albania* – 06.2025

6. Simbol i sigurisë (opsional):

P.sh., hologramë, ngjyrë UV ose dizajn antikopjim.

7. Forma dhe madhësia e etiketës:


Rrethore (p.sh., 3 cm diametër);

Drejtëndore (p.sh., 4 cm x 2 cm).

Shembull vizual i përshkrimit të një etikete/pulle (tekstualisht)



+-----+

| ALFA sh.p.k. |
| [Logoja këtu] |
| SN: 001294837B |
| QR code  |
| Made in Albania – 06.2025 |
| Originalitet i garantuar |

SHTOJCA II
KODI UNIK ALFANUMERIK PËR ARMË
(Në zbatim të neneve 13 dhe 15)

AL25-AR15-003581

(AL = Shqipëri, 2025, AR15 = lloji i armës, numër unik serial)

1. Numër serial, që ndjek një format të strukturuar:**AL24-AR15-003581**

- Ky format analizohet, si më poshtë:

i. AL – Shqipëria (kodi i vendit);**ii. 24** – Viti 2025;**iii. AR15** – Lloji i armës (AR-15, një armë gjysmautomatike);**iv. 003581** – Numri unik serial i armës (numër rendor).**2. Renditja e numri unik serial i armës:**

Numri **003581** është një **numër rendor serial** dhe zakonisht renditet sipas një **sistemi inkremental**, domethënë që rritet një nga një me çdo njësi të re të regjistruar.

3. Formatimi:

Është një numër me 6 shifra.

Shifrat e para (zero) janë **mbushëse** për të ruajtur gjatësi fikse (në këtë rast: 6).P.sh., Pas **003581** vjen **003582**, pastaj **003583** e kështu me radhë.**4. Rritja inkrementale:**Numri rritet **me +1** për çdo njësi të re të regjistruar të të njëjtit lloj (AR15 në këtë rast).Nëse arma tjetër është e tipit AR15 dhe është regjistruar pas kësaj, ajo do të ketë numrin **003582**.**5. Renditja në kontekst më të gjerë:**Numri është unik **brenda kategorisë së armës dhe vitit**.

Pra, AL24-AR15-003581 është arma e 3581-të e tipit AR15 e regjistruar në Shqipëri në vitin 2024.

Një armë e tipit tjetër, p.sh., AK47, do ketë një numër tjetër serial të ndarë, si p.sh., AL24-AK47-000142.

Shembuj të renditjes:

Numri serial i plotë	Renditja
AL24-AR15-000001	1
AL24-AR15-000002	2
...	...
AL24-AR15-003581	3,581
AL24-AR15-003582	3,582

6. Sistem automatik për gjenerimin e numrit serial në Excel.Krijimi i një **kodi serial të plotë** me formatin:

AL (viti)-(lloji_armës) - (numri_serial_me_6_shifra)



A	B	C	D
Vendi	Viti	Lloji i armës	Numri serial i plotë
AL	2024	AR15	(formulë që gjenerohet)

Shto formulën në kolonën **D** (Numri serial i plotë): Në rreshtin e parë (rreshti 2), vendos këtë formulë në kolonën **D**:

=A2 & TEXT(B2, "00") & "-" & C2 & "-" & TEXT (COUNTIFS (B\$2: B2, B2, C\$2:C2, C2), "000000")

- Si funksionon kjo formulë?

A2 – Vendi (p.sh., AL)

TEXT(B2, "00") – Shfaq vitin me dy shifra (p.sh., 2024 → 24)

C2 – Lloji i armës (p.sh., AR15)

COUNTIFS (B\$2: B2, B2, C\$2:C2, C2) – Numëron sa herë është përdorur ajo **armë** në atë **vit** deri në atë rresht (p.sh., 1 për të parën, 2 për të dytën etj.)

TEXT (... , "000000") – E shfaq numrin rendor me 6 shifra (p.sh., 000001)

Shembull:

A	B	C	D
AL	2024	AR15	AL24-AR15-000001
AL	2024	AR15	AL24-AR15-000002
AL	2024	AK47	AL24-AK47-000001
AL	2025	AR15	AL25-AR15-000001

MK22-G19-000847

(MK = Maqedoni e Veriut, *Glock* 19, numër unik)

IT25-762NATO-00592

(Itali 2025, kalibër 7.62 NATO, numër serial)

Shembuj për municion:

AL24-9MM-1000BX-A58Z

(Shqipëri, 2024, municion 9 mm, pako me 1000 fishekë, kod unik A58Z)

US23-556-LOT2847-K3R2

(SHBA, 5.56 mm, lote prodhimi, kod unik)

SHTOJCA III

(Në zbatim të neneve 19 dhe 20)

Për kontejnerët, që transportohen me anije, përdoren disa lloje markimesh standarde për të treguar informacion të rëndësishëm rreth përmbajtjes, trajtimit dhe destinacionit të tyre. Këto markime janë të përcaktuara në standardet ndërkombëtare të publikuara nga organizata ndërkombëtare, si: ISO (*International Organization for Standardization*) dhe IMDG (*International Maritime Dangerous Goods Code*) dhe më të rëndësishmet për transportin detar janë:

1. Markimi ISO 6346 (Kodi i kontejnerit)

- Ky është një kod standard ndërkombëtar, që përfshin:

i. **Kodi i pronarit** (p.sh. MSCU për MSC);

ii. **Kodi i llojit të kontejnerit;**

iii. **Numri serial i kontejnerit;**

iv. **Shifra kontrolli;**



v. Ky markim përdoret për identifikimin dhe gjurmimin e kontejnerëve;

vi. Standardi ISO 6346 “Kontejnerët e mallrave – Kodimi, identifikimi dhe shënjimi/markimi” është një standard ndërkombëtar i përcaktuar nga *International Organization for Standardization* (ISO) i adoptuar dhe i publikuar si standard shqiptar (SSH ISO 6346) për identifikimin e kontejnerëve të ngarkesave të përdorura në transportin ndërkombëtar.

- Struktura e Kodit ISO 6346

- Kodi përbëhet nga **11 karaktere alfanumerike** të ndara në pjesë, si më poshtë:

XXXX U 1234567

a) Kodi i pronarit (Owner code) – 3 shkronja

- Tregon kompaninë që zotëron kontejnerin.

- P.sh., “MSCU” për *Mediterranean Shipping Company* (MSC).

b) Shenja e pajisjes (Equipment category identifier) – 1 shkronjë

- “U” për kontejnerë të mallrave të përgjithshme;

- “J” për pajisje të bashkëngjitura;

- “Z” për rimorkio dhe trailera.

c) Numri serial (Serial number) – 6 shifra

- Numri serial (*Serial number*) është një **numër 6-shifror** që përdoret për **identifikimin unik të një kontejneri** brenda një kompanie pronare. Ky numër është i veçantë për çdo kontejner dhe shërben për qëllime gjurmimi, menaxhimi dhe dokumentimi të kontejnerëve në sistemin e brendshëm të kompanisë.

- Shembuj të numrave serialë:

i. 000123;

ii. 102478;

iii. 999999.

- Ky numër **nuk duhet të përsëritet** për më shumë se një kontejner brenda së njëjtës kompani pronare.

2. Kodi i madhësisë dhe llojit

Dy shkronja/numra specifikojnë gjatësinë, lartësinë dhe llojin e kontejnerit (p.sh. për qëllim të përgjithshëm).

Shembull: 22G1

22 = madhësia (lartësi standarde)

G1 = lloji

3. Shenjat operative

a) Tregues të peshës maksimale bruto, të ngarkesës së dobishme dhe peshës së vetë mjetit, të pajisjes ose të kontejnerit bosh.

b) Mund të përfshihen edhe udhëzime ose paralajmërime për trajtimin.

4. Kodi i vendit (opsional)

Bazuar në ISO 3166, ai tregon vendin ku kontejneri është i regjistruar ose operon.

5. Shifra e kontrollit (Check digit) – 1 shifër

- Përdoret për të verifikuar vlefshmërinë e kodit;

- Llogaritet nëpërmjet një formule matematikore të caktuar.

Shembull i plotë:

- MSCU 123456 5

- **MSC** – Kodi i pronarit (*Mediterranean Shipping Company*)

- **U** – Kontejner standard ngarkese

- **123456** – Numër unik serial

- **5** – Shifra e kontrollit

- **Markime të tjera operative dhe të trajtimit:**

a) “**This Side Up**” – për të treguar orientimin korrekt;

b) “**Do Not Stack**” – nuk duhet vendosur një kontejner tjetër sipër;

c) **Pesha bruto e kontejnerit (VGM – Verified Gross Mass)** – e detyrueshme sipas SOLAS-it.



- Markime të destinacionit

- Emërtimi i portit të destinacionit ose kodet e stacionit për sistemin logjistik.

- Etiketa për ngarkesë speciale

Kjo etiketë vendoset mbi kontejnerë, pajisje ose pako, që përmbajnë ngarkesa, që kërkojnë trajtim të veçantë, për shkak të rrezikut, të natyrës së brishtë, të kufizimeve të temperaturës ose të kushteve të transportit.

Etiketa për ngarkesë speciale tregon:

- llojin e rrezikut;
- kufizimet e trajtimit;
- kërkesa të posaçme të temperaturës;
- simbolet standarde ndërkombëtare për ngarkesa të rrezikshme sipas ADR/IMDG/ISO.

Mallrat ndahen në **9 klasa kryesore** bazuar në llojin e rrezikut që paraqesin:

Klasa	Përshkrimi
1.	Eksplzivë (p.sh., fishekzjarrë, dinamit)
2.	Gaze (të ndezshme, të pandezshme, toksike)
3.	Lëngje të ndezshme (p.sh., benzina, alkooli)
4.	Substanca të ngurta të ndezshme dhe të vetëreaktive
5.	Substanca oksiduese dhe perokside organike
6.	Substanca toksike dhe infektuese
7.	Materiale radioaktive
8.	Substanca gjerrëse (acidë, baza të forta)
9.	Substanca të tjera të rrezikshme (p.sh., lëndë që rrezikojnë mjedisin detar)

SHTOJCA IV

(Në zbatim të neneve 21, 22 dhe 23)

1. Kodi unik i lotit

Kodi i lotit për uniformat paraqitet në format alfanumerik të strukturuar dhe përbëhet nga:

- kodi i prodhuesit;
- data e prodhimit;
- numri progresiv i lotit;

Shembull:

ALB01-160426-L02

2. Struktura e kodit të lotit

Kodi i lotit paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:

ALB01-160426-L02

Ku:

- ALB01 – Kodi i prodhuesit;
- 160426 – Data e prodhimit (DDMMYY);
- L02 – Numri i lotit;

3. Shembull ilustrues i etiketës

+-----+

```

| PRODHUESI: ALB01 |
| LOT: ALB01-160426-L02 |
| PROD: 16.04.2026 |
| MADE IN ALBANIA |
| [QR CODE] |
+-----+

```




VENDIM
Nr. 535, datë 9.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN
E ANËTARËVE, FUNKSIONIMIN, SI
DHE MËNYRËN E USHTRIMIT TË
PËRGJEGJËSIVE TË KOMISIONEVE
KËSHILLIMORE PËR TITUJT
E NDERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave për përcaktimin e kriterëve, të procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisioneve këshillimore për titujt e nderit.

I. PËRBËRJA E KOMISIONIT KËSHILLIMOR

1. Institucionet përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit ngrenë komisionin këshillimor për titujt e nderit (në vijim, Komisioni Këshillimor), për të shqyrtuar paraprakisht nismat për dhënien e titujve të nderit, të cilat jepen në zbatim të ligjit nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Komisioni Këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 3 (tre) anëtarë të jenë punonjës nën varësinë e institucionit përgjegjës për dhënien e titullit dhe 2 (dy) anëtarë, personalitete të jashtme.

3. Komisioni Këshillimor ngrihet me urdhër të titullarit të institucionit përgjegjës për lëshimin e titullit të nderit. Anëtarët, personalitete të jashtme, përzgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura, që kanë dhënë kontribut në fushat përkatëse.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

1. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh me shumicë votash kryetarin. Detyra e sekretarit të Komisionit Këshillimor kryhet nga një punonjës i administratës së institucionit, sipas përcaktimit në urdhrin për ngritjen e këtij komisioni.

2. Veprimtaria e Komisionit Këshillimor u nënshtrohet rregullave në fuqi për mënyrën e

funksionimit të organeve kolegjiale. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

3. Anëtarët e Komisionit Këshillimor, të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

4. Gjatë veprimtarisë së tyre, anëtarët e Komisionit Këshillimor i nënshtrohen legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave.

5. Komisioni Këshillimor ngrihet për çdo nismë, kryesisht ose me propozim, që i paraqitet institucionit përgjegjës për lëshimin e titullit të nderit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për nderim.

6. Mbledhja e parë e Komisionit Këshillimor zhvillohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga ngritja e tij.

7. Në mbledhjen e parë, Komisioni Këshillimor njihet me objektin e veprimtarisë dhe shqyrton dokumentacionin që shoqëron praktikën.

8. Në çdo mbledhje mbahet procesverbal, ku pasqyrohen data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen, vendimet e marra dhe rezultati i votimeve.

9. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe u paraqitet për miratim dhe nënshkrim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.

10. Komisioni Këshillimor shqyrton dhe jep mendim, për:

a) plotësimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore formale nga kandidaturat e propozuara për titullin e caktuar të nderit;

b) të dhënat biografike të kandidatëve, që mbështesin meritën për përfitimin e titullit të nderit;

c) të dhënat biografike, nëse ka, të cilat i kundërvihen meritës;

ç) motivacionin që duhet të shoqërojë dhënien e titullit të nderit për kandidatët e propozuar.

11. Komisioni Këshillimor harton raport për çdo kandidaturë që shqyrton dhe përpilon rekomandim me shkrim për dhënien ose jo të titullit të nderit. Rekomandimi i Komisionit Këshillimor nuk është detyrues për institucionin përgjegjës për dhënien e titujve të nderit.

12. Komisioni Këshillimor, pasi merr praktikën që përmban propozimin ose nismën, i kërkon me shkresë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim, Autoriteti i Dosjeve) informacion lidhur me ekzistencën në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit të informacioneve për kandidatin. Përgjigja e



Autoritetit të Dosjeve jepet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar.

13. Kur përgjigja nga Autoriteti i Dosjeve vjen negative për kandidatin, Komisioni Këshillimor vijon procedurat për shqyrtimin e praktikës. Kur Autoriteti i Dosjeve konfirmon ekzistencën në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit të informacioneve për kandidatin, Komisioni Këshillimor, nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm, informon titullarin e institucionit për konstatimin e papajtueshmërisë. Në këtë rast, praktika arkivohet pa veprime të mëtejshme.

14. Në rastet kur praktika është mbështetur në propozimin e institucioneve me të drejtë ligjore propozimi, Komisioni Këshillimor shqyrton nëse propozimi është depozituar sipas afatit minimal 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e titullit dhe, në rast se ky afat nuk është respektuar, shqyrton nëse janë paraqitur shkaqe objektive ose të justifikueshme, të cilat lejojnë trajtimin e praktikës si rast përjashtimor pa cenuar kryerjen e rregullt të procedurës deri në datën e propozuar për akordimin e titullit të nderit. Gjithashtu, komisioni verifikon nëse dokumentacioni i propozimit plotëson kërkesat lidhur me përmbajtjen, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

15. Në varësi të konstatimit, Komisioni Këshillimor vendos:

a) të vijojë me shqyrtimin e nismës ose të propozimit;

b) t’i kërkojë institucionit, që ka ndërmarrë nismën kryesisht ose institucionit propozues plotësimin e të metave të propozimit për nderim brenda 10 (dhjetë) ditëve;

c) t’i dërgojë institucionit përgjegjës për dhënien e titullit rekomandimin për mospranimin e propozimit, kur ai është paraqitur në një afat më të ngushtë se afati 90-ditor i ligjit dhe nuk janë evidentuar shkaqe justifikuese për vijimin e procedurës përtej afatit.

16. Komisioni Këshillimor, kur çmon se praktika duhet të plotësohet me të dhëna dhe informacione shtesë, krahas informacionit e dokumentacionit të paraqitur në nismën ose propozimin për nderim,

kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe nga çdo person fizik ose juridik apo organ publik, vendas ose i huaj, që disponon të dhëna të vlefshme për shqyrtimin e plotë të nismës ose të propozimit. Kërkesa përcillet zyrtarisht nga sekretari i përgjithshëm i institucionit. Në shkresën përcjellëse informohet edhe për afatin, si rregull, 10-ditor, për të cilin Komisioni Këshillimor mbetet në pritje të përgjigjes.

17. Në çdo rast, Komisioni Këshillimor çmon se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në parimin e nderimit publik dhe të vlerësimit të kontributit, në vlerësimin e hollësishëm të informacioneve dhe dokumentacioneve në dispozicion, si dhe në rezultatin tërësor të shqyrtimit, duke hartuar për këtë qëllim raportin përkatës.

18. Komisioni Këshillimor shqyrton praktikën dhe dërgon mendimin për përmbushjen ose jo të kriterëve për nderim, si rregull, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për vijimin e shqyrtimit të propozimit ose nga plotësimi i të metave të tij. Procesi i shqyrtimit të nismës ose propozimit mund të shtyhet, me miratimin e titullarit të institucionit, përtej afateve të përcaktuara për shkak të rrethanave të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin e vlerën e aktit të nderimit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

19. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni Këshillimor i dërgon institucionit përgjegjës për dhënien e titullit mendimin e arsyetuar, për:

a) miratimin e nismës ose të propozimit;

b) refuzimin e nismës ose të propozimit për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit 10-ditor ose për shkak të mospërmbushjes së kriterëve, sipas këtij ligji.

20. Ngarkohen institucionet përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit, përcaktuar në ligjin nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 536, datë 9.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 203, DATË 10.4.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
MASËS SË PËRFITIMIT DHE LLOJEVE
TË PUSHIMEVE TË TJERA, ME APO PA
PAGESË, NË SHËRBBIMIN E MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 203, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 4, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, që shërben natën, në ditët e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale të punës, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

a) 20% për çdo orë pune të shërbimit të kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00;

b) 50% për çdo orë pune të shërbimit të kryer nga ora 22:00 deri në orën 6:00;

c) 25% për çdo orë pune të kryer në ditët e festave zyrtare dhe në ditët e pushimit javor.”;

b) Pas pikës 4, të kreut I, shtohen pikat 4/1, 4/2 dhe 4/3, me këtë përmbajtje:

“4/1. Për orët shtesë të punës, punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së kompensohet me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25% të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune apo me orët shtesë plus 50% të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.

4/2. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, kur festat zyrtare bien në ditë pushimi, trajtohet me një ditë pushimi shtesë ose pagesë për 8 (tetë)

orë, të përlogaritur mbi pagën orare të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu.

4/3. Shtesa mbi pagë, sipas pikës 4, të këtij kreu, paguhet bashkë me pagën mujore, brenda një muaji nga dita kur është kryer shërbimi. Kompensimi me pushim i orëve shtesë të punës, sipas pikave 4/1 e 4/2, të këtij kreu, bëhet brenda 2 (dy) muajve nga dita kur janë kryer ato. Në rast të pamundësisë së kompensimit të orëve shtesë të punës me pushim, punonjësi kompensohet me shtesë page, sipas masës së përcaktuar në pikat 4/1 e 4/2, të këtij kreu.”;

c) Pas pikës 6, të kreut I, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Numri maksimal i orëve shtesë për punonjësin operacional të shërbimit të MZSH-së nuk mund të jetë më shumë se 200 (dyqind) orë në vit. Me autorizimin e inspektoratit përgjegjës për inspektimin e punës, numri maksimal i orëve shtesë mund të tejkalohet vetëm në rastet e forcës madhore ose të menaxhimit të emergjencave civile në dobi të popullsisë.”;

ç) Pika 8, e kreut I, shfuqizohet;

d) Në pikën 1, të kreut II, emërtimet “komisar zjarrfikës”, “kryeinspektor zjarrfikës” dhe “inspektor zjarrfikës” zëvendësohen, përkatësisht, me “kryekomisar zjarrfikës”, “komisar zjarrfikës” dhe “nënkomisar zjarrfikës”.

2. Efektet financiare shtesë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkitë.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 537, datë 9.7.2026**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 33, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2026/897 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/1357 ...”;

b) Në aneksin 33, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/1357, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/1357

i 15 qershorit 2026

që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/891 mbi masat kufizuese në lidhje me veprimet që destabilizojnë Republikën e Moldavisë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 28 prill 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/891 ⁽¹⁾.
- (2) Bashkimi mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për Republikën e Moldavisë dhe qëndrueshmërinë, sigurinë, stabilitetin, ekonominë dhe furnizimin e saj me energji përballë aktiviteteve destabilizuese nga aktorët e jashtëm.
- (3) Duke pasur parasysh situatën në Republikën e Moldavisë, Këshilli konsideron se gjashtë persona duhet të shtohen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2023/891.
- (4) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2023/891 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2023/891 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Luksemburg, më 15 qershor 2026.

*Për Këshillin**President*

K. KALLAS

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/891 i datës 28 prill 2023 mbi masat kufizuese në lidhje me veprimet që destabilizojnë Republikën e Moldavisë (OJ L 114, 2.5.2023, f. 15, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/891/oj>).



EN

OJ L, 15.6.2026

SHITOJË

Në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2023/891, shtohen shënimet e mëposhtme nën titullin "A. Personat fizikë";

Emri	Informacion identifikues	Deklarata e arsyeve	Data e listimit
"24. Alina JUC	Funksioni: Koordinator në rrjetin e dezinformimit të Ilan Shor Data e lindjes: 5.11.2000 Vendi i lindjes: Rîbnîța, Republika e Moldavisë Gjinia: femër Kombësia: Republika e Moldavisë	Alina Juc ishte koordinatorë rrjeti në një operacion sekret të financuar nga Rusia, të lidhur me Ilan Shor, që synonte prishjen e zgjedhjeve parlamentare të shtatorit 2025. Ajo ishte e ngarkuar me rekrutimin, koordinimin dhe ofrimin e pagesave për aktivitate dezinformuese të kryera përmes rrjetit. Fushata dezinformuese ishte në vazhdim para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 me qëllim forcimin e mbështetjes së përfaqësuesve të Ilan Shor duke kryer aktivitate sondazhesh që synonin shtrëmbërimin e realitetit zgjedhor. Alina Juc punon brenda një strukture më të gjerë të ndërtuar rreth një shoqate joqeveritare, Evrazia, njëti përmes të cilit u organizuan rekrutimi, trajnimi, shpërndarja e propagandës dhe rrjetet në terren. Brenda kësaj arkitekture, ajo vepron si koordinatorë që ekzekutojnë programet e Evrazia-s në Republikën e Moldavisë, duke lidhur kështu përpjekjet lokale të manipulimit zgjedhor me rrjetin e lidhur me Shor dhe rrjetin e lidhur me Evrazia-n. Përmes rekrutimit, drejtimit operativ, koordinimit të pagesave dhe ekzekutimit të strategjisë, Alina Juc luajti një rol qendror në zbatimin e një fushate dezinformimi dhe objektivash për prishjen e zgjedhjeve. Prandaj, ajo është përgjegjëse për dhe zbaton veprime që dëmtojnë ose kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe stabilitetin në Republikën e Moldavisë, duke penguar dhe minuar procesin politik demokratik, duke përfshirë pengimin dhe minimin serioz të mbajtjes së zgjedhjeve dhe përpjekjen për të përmbytur rendin kushtetues në Republikën e Moldavisë. Për më tepër, ajo është e lidhur me Ilan Shor dhe Evrazia-n.	15.6.2026



	Emri	Informacion identifikues	Deklarata e arsyeve	Data e listimit
25.	Anton TREGUB (Антон ТРЕГУБ)	Funksioni: Kurator i partisë politike Data e lindjes: 8.3.1986 Vendi i lindjes: Goryachy Klyuch, Krasnodar, BRSS (tani Federata Ruse) Gjinia: Mashkull Kombësia: Ruse	Anton Tregub është një shtetas rus i cili vepron si kurator nga Moskë për partinë politike Moldova Mare në Republikën e Moldavisë. Përpilimi i listës së kandidatëve dhe strategjia zgjedhore e partisë Moldova Mare u drejtuan nga Anton Tregub. Në këtë kuptim, Anton Tregub kontrolloi përpilimin e listës së kandidatëve, duke e paralajmëruar Victoria Furtună, udhëheqësen e partisë Moldova Mare, që të siguronte regjistrimin e partisë për zgjedhjet, duke e inkurajuar atë të korruptonte Komisionin Qendror Zgjedhor, nëse ishte e nevojshme. Anton Tregub gjithashtu diskutoi dhe ra dakord me Victoria Furtunë për t'u ofruar mallra të burgosurve në këmbim të votave, si dhe për t'i detyruar të burgosurit të votojnë për partinë e saj në zgjedhjet parlamentare të shtatorit 2025. Më 26 shtator 2025, partia Moldova Mare u përjashtua nga pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare për shkak të financimit të paligjshëm dhe blerjes së votuesve. Duke kontrolluar strategjinë e partisë politike Moldova Mare dhe duke u përfshirë drejtpërdrejt në marrjen e paligjshme të votave për Victoria Furtunë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, Anton Tregub është përgjegjës për veprime që dëmtojnë dhe kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit ose stabilitetin në Republikën e Moldavisë dhe duke zbatuar ato, duke penguar dhe minuar procesin politik demokratik, duke përfshirë pengimin dhe minimin serioz të mbajtjes së zgjedhjeve dhe përpjekjen për të përmbysur rendin kushtetues në Republikën e Moldavisë.	15.6.2026



EN

OJ L, 15.6.2026

	Emri	Informacioni identifikues	Deklarata e arsyeve	Data e listimit
26.	Anton USOV (Антон УСОВ)	Funksioni: Aktivist në Frontin Popullor – Ekipi i Putinit Data e lindjes: 3.4.1986 Vendi i lindjes: Vladimir, BRSS (tani Federata Ruse) Gjinia: Mashkull Kombësia: Ruse	Anton Usov është një aktivist në Frontin Popullor - Ekipi i Putinit, i cili u infiltrua në strukturat kishare të Republikës së Moldavisë, duke koordinuar një fushatë të strukturuar ndikimi që synonte zgjedhjet parlamentare të vendit të vitit 2025. Ai mbikëqyri mesazhet, mobilizimin e klerit dhe rreshtimin politik brenda Dioqezës së Sorokës dhe Drochiisë. Ai përdori platforma fetare, veçanërisht kanalën Telegram "Salt and Light" dhe median e shtypur "Salt and Light", për të përhapur narrativa që përzenin diskursin ortodoks me mesazhet politike, ndërsa udhëzonte priftërinjtë se si dhe për kë duhet të votonin famullitarët. Anton Usov zbatoi mekanizma të kontrollit operacional dhe mobilizimit zgjedhor duke anketuar priftërinjtë për të vlerësuar besnikërinë politike, duke kushtëzuar ndihmën financiare me pajtueshmërinë, duke lehtësuar pagesat përmes kanaleve ruse dhe duke kërkuar "foto besnikërie" të tubimeve famullitare për të raportuar aktivitetin në Moskë. Ai akuzohet më tej për organizimin e mbledhjes sistematike të dhënave personale të besimtarëve gjatë ngjarjeve fetare, pelegrinazheve dhe programeve kishare me qëllim ndërtimin e bazave të të dhënave të votuesve për mobilizim të synuar. Duke vepruar si një ndërmjetës strategjik midis strukturave politike ruse dhe segmenteve të klerit në Republikën e Moldavisë, duke përdorur autoritetin fetar, leva financiare dhe mesazhe dixhitale të koordinuara për të ndikuar në proceset zgjedhore demokratike. Anton Usov është përgjegjës për veprimet dhe politikat që dëmtojnë dhe kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe stabilitetin në Republikën e Moldavisë dhe duke i zbatuar ato, përmes veprimeve që pengojnë dhe dëmtojnë procesin politik demokratik, duke përfshirë edhe pengimin dhe dëmtimin serioz të mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Moldavisë.	15.6.2026



	Emri	Informacion identifikues	Deklarata e arsyeve	Data e listimit
27.	Irina VLAH	Funksioni: Kryetar i partisë politike "Inima Moldovei"; ish-Bashkan i Gagauzisë (2015-2023) Data e lindjes: 27.2.1974 Vendi i lindjes: Comrat, SSR Moldavia (tani Republika e Moldavisë) Gjinia: Femër Kombësia: Republika e Moldavisë	Irina Vlah është udhëheqësja e partisë politike "Inima Moldovei". Ajo ishte e angazhuar në mënyrë aktive në aktivitete që synonin destabilizimin e proceseve demokratike që po zhvilloheshin në Republikën e Moldavisë përpara zgjedhjeve parlamentare të shtatorit 2025. Irina Vlah ndërmori vizita të dokumentuara në Moskë në vitin 2025 së bashku me personin e listuar Victoria Furtună. Të dyja u takuan me zyrtarë të lartë rusë, ku morën siguri në lidhje me mbështetjen e fushatës dhe udhëzimet për koordinimin zgjedhor. Pas formimit të një blloku të ri politik, bllokut politik "patriotik", Irina Vlah bashkëorganizoi një tubim zgjedhor të paguar në korrik 2025, duke u shtirur si mbështetëse publike për bllokun e sapoformuar. Irina Vlah dhe partia e saj kontrollohen nga personi i listuar Ilan Shor dhe kanë marrë përsipër një numër funksionesh që nuk kryhen më nga partitë e autorizuara që ishin ndaluar ose zgjedhjet nga zgjedhjet. Duke minuar procesin politik demokratik, duke përfshirë edhe përpjekjen për të destabilizuar dhe përmbysur rendin kushtetues, Irina Vlah është përgjegjëse për veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, si dhe demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin dhe sigurinë në Republikën e Moldavisë, si dhe zbatimin e tyre. Ajo është gjithashtu e lidhur me Ilan Shor.	15.6.2026



EN

OJ L, 15.6.2026

	Emri	Informacion identifikues	Deklarata e arsyeve	Data e listimit
28.	Iuri VITNEANSKI	Funksioni: Anëtar i partisë politike "Renaștere". Data e lindjes: 6.8.1989 Vendi i lindjes: Bălți, SSR Moldavia (tani Republika e Moldavisë) Gjinia: Mashkull Kombësia: Republika e Moldavisë	Iuri Vitneanski është anëtar i partisë politike "Renaștere", e cila është pjesë e bllokut politik Victory/Pobeda. Ai angazhohet në mënyrë aktive në përhapijen e dezinformatave dhe taktikave të frikësimit, si dhe në narrativa të përsëritura rreth kërcënimeve të supozuara ndaj neutralitetit ose "militarizimit" të Republikës së Moldavisë. Iuri Vitneanski vepron nën mbikëqyrjen e personit të listuar Ilan Shor, nga i cili merr pagë mujore. Iuri Vitneanski gjithashtu merr pjesë në veprime publike të koordinuara nga entiteti i listuar Evrazia, një shoqatë joqeveritare, Iuri Vitneanski ka marrë pjesë në disa takime së bashku me individë të shumtë nga rrethimi i Ilan Shor. Duke minuar procesin politik demokratik, duke përfshirë edhe përpjekjen për të destabilizuar dhe përmbysur rendin kushtetues, Iuri Vitneanski po zbaton dhe mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe stabilitetin në Republikën e Moldavisë. Ai është gjithashtu i lidhur me Ilan Shor, bllokun politik Victory/Pobeda dhe Evrazia.	15.6.2026
29.	Ruslan GARBALI	Funksioni: Kryetar i Organizatës Territoriale "Vulcănești" i partisë politike "Renaștere". Data e lindjes: 3.6.1970 Vendi i lindjes: Ceadr-Lunga, SSR Moldavia (tani Republika e Moldavisë) Gjinia: Mashkull Kombësia: Republika e Moldavisë	Ruslan Garbali është Kryetari i organizatës territoriale "Vulcănești" të partisë politike "Renaștere" në Republikën e Moldavisë. Ai ishte i përfshirë në organizimin e protestave të paguara në pritje të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025. Protestat u njoftuan nga Ilan Shor, dhe Ruslan Garbali kishte rolin ekzekutiv të kontaktimit të pjesëmarrësve dhe sigurimit të pagesës së tyre. Për më tepër, ai mori pjesë në aktivitetin e lançimit të bllokut politik "Victory/Pobeda", së bashku me Ilan Shor. Duke minuar procesin politik demokratik, duke përfshirë edhe përpjekjen për të destabilizuar ose përmbysur rendin kushtetues, Ruslan Garbali po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe stabilitetin në Republikën e Moldavisë. Ai është gjithashtu i lidhur me Ilan Shor.	15.6.2026



2026/1357

15.6.2026

COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/1357**of 15 June 2026****amending Decision (CFSP) 2023/891 concerning restrictive measures in view of actions destabilising the Republic of Moldova**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 28 April 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/891 ⁽¹⁾.
- (2) The Union remains unwavering in its support for the Republic of Moldova and its resilience, security, stability, economy and energy supply in the face of destabilising activities by external actors.
- (3) In view of the situation in the Republic of Moldova, the Council considers that six persons should be added to the list of natural and legal persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision (CFSP) 2023/891.
- (4) Decision (CFSP) 2023/891 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2023/891 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 15 June 2026.

*For the Council**The President*

K. KALLAS

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2023/891 of 28 April 2023 concerning restrictive measures in view of actions destabilising the Republic of Moldova (OJ L 114, 2.5.2023, p. 15, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/891/oj>).



EN

OJ L, 15.6.2026

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2023/891, the following entries are added under the heading 'A. Natural persons':

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
'24.	Alina JUC	Function: Coordinator in Ilan Shor's disinformation network DOB: 5.11.2000 POB: Ribnița, Republic of Moldova Gender: female Nationality: Republic of Moldova	Alina Juc was a network coordinator in a secret Russian-funded operation linked to Ilan Shor and aimed at disrupting the parliamentary elections of September 2025. She was tasked with recruiting, coordinating and offering payments for disinformation activities carried out through the network. The disinformation campaign was ongoing before the 2025 parliamentary elections with the purpose of boosting Ilan Shor's proxies by carrying out polling activities meant to distort the electoral reality. Alina Juc works within a broader structure built around a non-governmental association, Evrazia, the vehicle through which recruitment, training, propaganda dissemination and field networks were organised. Within that architecture, she acts as a coordinator executing Evrazia's programmes in the Republic of Moldova, thereby connecting local electoral manipulation efforts to the Shor-linked network and Evrazia-linked network. Through recruitment, operational direction, payment coordination and strategy execution, Alina Juc played a central role in implementing a campaign of disinformation and election-disruption objectives. Therefore, she is responsible for, and implementing actions which undermine or threaten democracy, the rule of law and stability in the Republic of Moldova, by obstructing and undermining the democratic political process, including by obstructing and seriously undermining the holding of elections and attempting to overthrow the constitutional order in the Republic of Moldova. Furthermore, she is associated with Ilan Shor and Evrazia.	15.6.2026



OJ L 15.6.2026

EN

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
25.	Anton TREGUB (Антон ТРЕГУБ)	Function: Political party curator DOB: 8.3.1986 POB: Goryachy Klyuch, Krasnodar, USSR (now Russian Federation) Gender: male Nationality: Russian	Anton Tregub is a Russian national who is acting as a curator from Moscow for the Moldova Mare political party in the Republic of Moldova. The compilation of the candidate list and electoral strategy of the Moldova Mare party were directed by Anton Tregub. In this sense, Anton Tregub controlled the compilation of the candidate list, warning Victoria Furtună, the leader of the Moldova Mare party, to secure the registration of the party for the elections, encouraging her to bribe the Central Electoral Commission, if needed. Anton Tregub also discussed and agreed with Victoria Furtună to offer goods to prisoners in exchange for votes as well as forcing prisoners to vote for her party in the parliamentary elections of September 2025. On 26 September 2025, the Moldova Mare party was excluded from participating in the parliamentary elections because of illegal financing and voter buying. By controlling the strategy of the Moldova Mare political party and his direct involvement in illegally obtaining votes for Victoria Furtună in the 2025 parliamentary elections, Anton Tregub is responsible for, and implementing actions which undermine and threaten democracy, the rule of law or stability in the Republic of Moldova, by obstructing and undermining the democratic political process, including by obstructing and seriously undermining the holding of elections and attempting to overthrow the constitutional order in the Republic of Moldova.	15.6.2026

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/1357/oj>

3/6



EN

OJ L, 15.6.2026

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
26.	Anton USOV (Антон УСОВ)	Function: Activist in the Popular Front – Putin's Team DOB: 3.4.1986 POB: Vladimir, USSR (now Russian Federation) Gender: male Nationality: Russian	Anton Usov is an activist in the Popular Front – Putin's Team, who infiltrated the church structures of the Republic of Moldova, coordinating a structured influence campaign targeting the country's parliamentary elections of 2025. He oversaw messaging, clergy mobilisation and political alignment within the Diocese of Soroca and Drochia. He used religious platforms, particularly the "Salt and Light" Telegram channel and the print outlet "Salt and Light", to disseminate narratives blending Orthodox discourse with political messaging, while instructing priests how and for whom parishioners should vote. Anton Usov implemented mechanisms of operational control and electoral mobilisation by surveying priests to assess political loyalty, conditioning financial assistance on compliance, facilitating payments through Russian channels and requiring "loyalty photos" of parish gatherings to report activity back to Moscow. He is further accused of organising systematic collection of believers' personal data during religious events, pilgrimages and church programmes in order to build voter databases for targeted mobilisation. By acting as a strategic intermediary between Russian political structures and segments of the clergy in the Republic of Moldova, using religious authority, financial leverage, and coordinated digital messaging to influence the democratic electoral processes, Anton Usov is responsible for, and implementing actions and policies which undermine and threaten democracy, the rule of law and stability in the Republic of Moldova, through actions obstructing and undermining the democratic political process, including by obstructing and seriously undermining the holding of elections in the Republic of Moldova.	15.6.2026



OJ L, 15.6.2026

EN

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
27.	Irina VLAH	Function: Leader of the “Inima Moldovei” political party; former Bashkan of Gagauzia (2015-2023) DOB: 27.2.1974 POB: Comrat, SSR Moldova (now Republic of Moldova) Gender: female Nationality: Republic of Moldova	Irina Vlah is the leader of the “Inima Moldovei” political party. She was actively engaged in activities aimed at destabilising the democratic processes taking place in the Republic of Moldova ahead of the September 2025 parliamentary elections. Irina Vlah undertook documented visits to Moscow in 2025, alongside listed person Victoria Furtună. The two met with high-ranking Russian officials, where they received assurances regarding campaign support and electoral coordination instructions. Following the formation of a new political bloc, the “patriotic” political bloc, Irina Vlah co-organised a paid election rally in July 2025, feigning public support for the newly formed bloc. Irina Vlah and her party are controlled by listed person Ilan Shor, and have taken over a number of functions that are no longer performed by the proxy parties that had been outlawed or barred from elections. By undermining the democratic political process, including by attempting to destabilise and overthrow the constitutional order, Irina Vlah is responsible for, and implementing actions and policies which undermine and threaten the sovereignty and independence of the Republic of Moldova, and democracy, the rule of law, stability and security in the Republic of Moldova. She is also associated with Ilan Shor.	15.6.2026



EN

OJ L, 15.6.2026

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
28.	Juri VITNEANSKI	Function: Member of the “Renaștere” political party DOB: 6.8.1989 POB: Bălți, SSR Moldova (now Republic of Moldova) Gender: male Nationality: Republic of Moldova	Juri Vitneanski is a member of the “Renaștere” political party, which is part of the Victory/Pobeda political bloc. He actively engages in the dissemination of disinformation and scare tactics, as well as recurring narratives about supposed threats to the neutrality or the “militarisation” of the Republic of Moldova. Juri Vitneanski acts under the supervision of listed person Ilan Shor, from whom he receives monthly pay. Juri Vitneanski also participates in public actions coordinated by listed entity Evrazia, a non-governmental association. Juri Vitneanski has taken part in several meetings alongside multiple individuals from Ilan Shor’s entourage. By undermining the democratic political process, including by attempting to destabilise and overthrow the constitutional order, Juri Vitneanski is implementing and supporting actions and policies which undermine and threaten democracy, the rule of law and stability in the Republic of Moldova. He is also associated with Ilan Shor, the Victory/Pobeda political bloc and Evrazia.	15.6.2026
29.	Ruslan GARBALI	Function: Head of “Vulcănești” territorial organisation of the “Renaștere” political party DOB: 3.6.1970 POB: Ceadir-Lunga, SSR Moldova (now Republic of Moldova) Gender: male Nationality: Republic of Moldova	Ruslan Garbali is the Head of the “Vulcănești” territorial organisation of the “Renaștere” political party in the Republic of Moldova. He was involved in organising paid protests in anticipation of the parliamentary elections of 2025. The protests were announced by Ilan Shor, and Ruslan Garbali had the executive role of contacting the participants and ensuring they were paid. Moreover, he participated in the launch event for the “Victory/Pobeda” political bloc, alongside Ilan Shor. By undermining the democratic political process, including by attempting to destabilise or overthrow the constitutional order, Ruslan Garbali is supporting actions and policies which undermine and threaten democracy, the rule of law, and stability in the Republic of Moldova. He is also associated with Ilan Shor.	15.6.2026



VENDIM
Nr. 538, datë 9.7.2026

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
I TROTUAREVE, LAGJJA ‘SHEH’”,
BASHKIA KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të bashkëpronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i trotuareve, lagjja ‘Sheh’”, Bashkia Kavajë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kavajë.

3. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 452 308 (katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 452 308 (katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Kavajë.

8. Bashkia Kavajë kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kavajë.

10. Bashkia Kavajë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kavajë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION I TROTUAREVE LAGJJA ‘SHEH’” BASHKIA KAVAJË

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)										Vlerësimi për shpronësim Lloji “truall”			Vlerësimi për “ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmim (lekë/m²)	Vera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmim (lekë/m²)	Vera (lekë)		
1	Hysen Dhurata Flutura Gezim Mentor Yllka Ilaria Nikolas Yllka	Zenel Qemal Qemal Qemal Fehemi Fehemi Claudio Gazment Fehmi	Shehi Cara Beqari Shehi Shehi Gjeçi (Shehi) Taddei Shehi Shehi	Kavajë	8552	8/148	Truall	577		577	194.82	10	128	58.4	7,745	452,308				452,308	
VLERA TOTALE																				452,308	

**VENDIM****Nr. 539, datë 9.7.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I SHESHEVE DHE
ZONAVE KRYESORE NË AFËRSI TË
PIKAVE DOGANORE SHQIPTARE (PIKA
DOGANORE MORINË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare (Pika Doganore Morinë).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 184 982 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 184 982 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kukës, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë që shpronësohen sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kukës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I SHESHEVE DHE ZONAVE KRYESORE NË AFËRSI TË PIKAVE DOGANORE SHQIPTARE (PIKA DOGANORE MORINË)”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim sipas llojit						Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall	Arë	Ndërtesë	Truall			Arë				
											Sipërfaqja e shpronësuar m²	Çmimi	Vlera	Sipërfaqja e shpronësuar m²	Çmimi	Vlera		
1	Kujtim Ylber Rive	Islam Iljaz	Duraku Duraku Duraku	2724	90/6	Truall	1,971	1971			670	203	136,010			136,010		
2	Qemal		Duraku	2724	80/9	Arë	283		283					22	132	2,904	2,904	
3	Lulzim	Zaim	Duraku	2724	80/2	Arë	650		650					152	132.00	20,064.00	20,064	
4	Zaim	Ajet	Duraku	2724	80/1	Arë	760		760					197	132.00	26,004.00	26,004.00	
	VLERA TOTALE																184,982.00	



VENDIM
Nr. 540, datë 9.7.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
ZBATIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E EKONOMISË DHE
INOVACIONIT, DHE AGJENCISË
GJERMANE PËR BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR (GIZ) GMBH, SI
PËRFAQËSUESE E QEVERISË
GJERMANE DHE AGJENCI ZBATUESE,
PËR PROGRAMIN “QENDRAT PËR
MIGRACION DHE ZHVILLIM” (ZME)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për programin “Qendrat për migracion dhe zhvillim” (ZME), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE ZBATIMI

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Tiranë

- referuar në vijim si “partneri zbatues” -

dhe

**AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR, (GIZ) GmbH**
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

- referuar në vijim si “GIZ” -

në lidhje me projektin e Programit
“Qendrat për Migracion dhe Zhvillim” (ZME)

- referuar në vijim si “Projekti” -



Baza e marrëveshjes

Sa më poshtë vijon përbën bazën e kësaj marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, e datës 21 tetor 1988. (shihni Aneksin 1)
- Procesverbali Përmbledhës i Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mbajtur në Tiranë më 13-14 nëntor 2022. (shihni Aneksin 2)
- Autorizimi i Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), i datës 6.7.2023. (shihni Aneksin 4)
- Ligji Nr. 59/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për Migracionin në Shqipëri”. Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 20.9.2018. (shihni Aneksin 5)



1. Objektivi i projektit dhe treguesit

29	489049.0118	4671778.263	91	491245.0153	4676928.889	153	492109.7727	4679190.535
30	489061.7011	4671824.731	92	491201.2344	4676994.546	154	492178.6886	4679272.337
31	489071.0824	4671871.16	93	491137.644	4677056.661	155	492273.592	4679440.2
32	489090.0001	4671950.786	94	491064.3622	4677098.812	156	492403.5155	4679601.063
33	489098.7653	4671985.056	95	490954.7695	4677133.92	157	492461.7772	4679688.563
34	489124.7988	4672086.842	96	490782.2849	4677171.599	158	492507.4851	4679763.21
35	489189.5249	4672210.015	97	490729.3184	4677193.567	159	492546.8663	4679835.666
36	489217.3837	4672260.122	98	490534.9088	4677287.826	160	492592.4499	4679920.899
37	489228.4072	4672279.949	99	490456.0386	4677343.122	161	492629.5151	4680010.267
38	489273.9831	4672343.345	100	490336.1337	4677411.194	162	492633.5368	4680020.674
39	489316.5223	4672383.546	101	490221.6381	4677469.404	163	492668.6344	4680056.886
40	489382.2178	4672424.018	102	490093.8017	4677536.721	164	493127.2889	4679928.463
41	489481.0715	4672458.262	103	489974.0288	4677593.546	165	493462.386	4679834.635
42	489560.3094	4672472.425	104	489872.9052	4677640.002	166	492748.0096	4678707.508
43	489732.0564	4672497.597	105	489790.3067	4677686.675	167	491335.1317	4677866.131
44	489917.1132	4672516.309	106	489775.0083	4677697.959	168	492478.134	4676818.379
45	489978.4243	4672513.803	107	489722.491	4677736.698	169	492303.5087	4675596.002



46	490105.7884	4672508.595	108	489700.9328	4677764.17	170	492017.7581	4674405.375
47	490260.9566	4672536.882	109	489665.9583	4677802.832	171	490906.5059	4672198.745
48	490445.9361	4672562.21	110	489643.8146	4677829.041	172	490604.8803	4671119.243
49	490495.2854	4672585.948	111	489627.5789	4677859.288	173	491859.0078	4670293.741
50	490577.5602	4672623.307	112	489619.3369	4677884.998	174	491552.9151	4668685.337
51	490629.7522	4672686.78	113	489611.0714	4677912.692	175	490304.9724	4668349.868
52	490648.8302	4672737.271	114	489598.7287	4677956.642	176	490238.6824	4668329.536
53	490658.6328	4672763.214	115	489595.4914	4678001.729	177	490234.8858	4668394.302
54	490690.2008	4672892.616	116	489607.7099	4678043.162	178	490244.4373	4668737.21
55	490794.4025	4673317.327	117	489621.3858	4678095.729	179	490297.9889	4668925.09
56	490829.0071	4673469.924	118	489647.6528	4678157.973	180	490346.9381	4669039.476
57	490837.9228	4673556.05	119	489673.9384	4678218.628	181	490382.7172	4669148.414
58	490840.3388	4673632.174	120	489720.7918	4678285.877	182	490405.5429	4669233.379
59	490842.9099	4673695.066	121	489761.4241	4678341.937	183	490430.5501	4669358.072
60	490841.9403	4673777.767	122	489779.402	4678359.142	184	490432.8844	4669375.349
61	490848.0134	4673824.158	123	489833.6647	4678411.072	185	490442.7281	4669448.206
62	490870.2	4673907.13	124	489932.7684	4678491.639	186	490454.379	4669583.33

ZONA ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE
ZONA 7, NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË MALI DHE BLERIM, BASHKIA FUSHË-ARRËZ, QARKU SHKODËR





Zona 7		
Njësia Administrative Qafë Mali dhe Blerim		
Nr.	Koordinata X	Koordinata Y
1	502231.6501	4664834.681
2	502324.2545	4667480.519
3	504010.9766	4668737.293
4	505712.7691	4665929.12
5	506519.7499	4664764.951
6	505725.9983	4663296.511
7	505633.3939	4662357.238
8	507273.8139	4662079.425
9	508437.9829	4662740.885
10	507855.8984	4663455.261
11	508385.0661	4664275.471
12	510184.2364	4663336.198
13	512962.221	4661768.62
14	512929.148	4660505.233
15	509919.6525	4661629.633
16	508662.8791	4661457.653
17	507459.0226	4661140.152
18	506268.3952	4660849.11
19	505514.3312	4659433.586
20	504125.2659	4659856.921
21	502603.9087	4662449.842
22	502231.6501	4664834.681

VENDIM

Nr. 544, datë 9.7.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË
ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE,
PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE
NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave,

trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë



dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut I, bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Pas emërimit “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike” shtohet “Qendra për Hapje dhe Dialog, “COD””;

ii. Pas emërimit “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar” shtohet “Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar”.

b) Në lidhjen nr. 3, bashkëlidhur vendimit, pas pikës 29 shtohet pika 30, me këtë përmbajtje:

“30. Në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”, nëpunësit në pozicionet “titullar institucioni” dhe “drejtor drejtorie” të drejtorive të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.”.

c) Lidhja nr. 8/1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në lidhjen nr. 10, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Pas emërtesës “Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit” shtohet “Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”.”;

ii. Pas emërtesës “Kapiten i Portit” shtohet “Kordinator në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe fillojnë:

a) nga data 1 korrik 2026, për përcaktimin e shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi;

b) nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë, për të gjitha përcaktimet e tjera.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Qendra për Hapje dhe Dialog, “COD” dhe Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 8/1

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-2	1	90 000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-1	1	70 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI; Drejtor drejtorie të drejtorive IT të atashuara pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore.	II-1	1	70 000
Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.	II-1	1	0
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	III-1	1	50 000
Përgjegjës sektori në sektorët IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-2	1	60 000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor.	III-3	1	40 000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-2	1	0



Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	IV-1	1 ose 2	60 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë Kryeministrit, ministrave të linjës dhe pranë institucioneve qendrore; Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore.	IV-1	1 ose 2	60 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore.	IV-3	1 ose 2, ose	55 000
	IV-4	3	
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2, ose	0
	IV-3	3	0

VENDIM**Nr. 548, datë 9.7.2026**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
SHËRBIMIT TË PROVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Besmir Kola emërohet drejtor i përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 70, datë 8.6.2026**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare;

me sekretare Anjeza Puka, në datën 8.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (GJ) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Genci Gjonçaj.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Engjëll Agaçi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 5, pika 2, dhe 6 të ligjit nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, në pjesën ku vendoset kriteri tavan për dëmshpërblimin e paraburgimit, burgimin dhe arrestin në shtëpi të padrejtë, respektivisht në 3.000 (tre mijë) lekë, 2.000 (dy mijë) lekë dhe 1.000 (një mijë) lekë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë (*Gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 30.3.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të dy shtetasve dhe ka caktuar ndaj tyre masën e sigurimit “Arresti në burg”, si të dyshuar për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134, paragrafi i dytë, i Kodit Penal (KP). Pas përfundimit të hetimeve paraprake, çështja është dërguar për gjykim.

2. Në gjykimin në shkallë të parë akuza penale është ndryshuar dhe në përfundim, njëri prej të pandehurve është deklaruar fajtor për veprën penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë, i KP-së, është dënuar me 8 muaj burgim dhe është liruar në datën 13.12.2018. I pandehuri tjetër është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të moskallëzimit të krimit, të parashikuar nga neni 300 i KP-së, dhe është liruar në të njëjtën datë.

3. Në datën 4.4.2025 të dy shtetasit kanë paraqitur padi të përbashkët për kompensim për burgim të padrejtë. Shtetasi i deklaruar i pafajshëm ka kërkuar kompensimin e paraburgimit prej 8 muajsh e 15 ditësh në shumën 1.164.000 lekë, ndërsa shtetasi i dënuar ka kërkuar kompensimin e periudhës së paraburgimit që tejkalonte me 3 muaj e 5 ditë masën e dënimit, në shumën 450.000 lekë.

4. Çështja është regjistruar në gjykatën referuese. Në seancën e datës 3.6.2025 ajo gjykatë, duke u mbështetur në nenet 134, pika 1, dhe 145, pika 2, të Kushtetutës, ka vendosur kryesisht t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) shfuqizimin si antikushtetuese të neneve 5, pika 2, dhe 6 të ligjit nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” (*Ligji për Kompensimin e Burgimit*), në pjesën që parashikon kufirin maksimal të dëmshpërblimit për paraburgimin, burgimin dhe arrestin në shtëpi të padrejtë. Njëkohësisht, ajo ka pezulluar gjykimin e saj deri në vendimmarrjen e Gjykatës.

5. Kolegji i Gjykatës në datën 23.9.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. *Gjykata referuese*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se dispozitat e kundërshtuara cenojnë të drejtën kushtetuese të zhdëmtimit në përputhje me ligjin, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës dhe neni 5, pika 5, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi:

6.1. Masa e kompensimit që përlogaritet, sipas tyre, nuk është në raport të drejtë me dëmin pasuror dhe jopasuror që i shkaktohet individit, ndaj dëmshpërblimi nuk është i plotë dhe i drejtë.

6.2. Dëmshpërblimi për burgimin e padrejtë nuk kalon pagën mesatare në rang vendi, ndërsa për arrestin në shtëpi nuk kalon as pagën minimale.

6.3. Dëmshpërblimi për individin që ka pagë më të lartë se mesatarja asnjëherë nuk është i drejtë.

6.4. Mekanizmi i zgjedhur nga shteti shqiptar për kompensimin për burgim të padrejtë nuk jep qartësi dhe siguri për dhënien e një kompensimi të plotë. Shpërblimi është pothuajse i papërfillshëm, pasi nuk mbulon as dëmin pasuror, as atë jopasuror, duke e lënë individin tërësisht të pambrojtur përballë organeve publike.

7. *Subjekti i interesuar, Kuvendi*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se dispozitat e kundërshtuara nuk bien ndesh me nenin 44 të Kushtetutës dhe me nenin 5, pika 5, të KEDNJ-së, pasi:

7.1. Ato sigurojnë një standard të mjaftueshëm për mbrojtjen e individit dhe një ekuilibër të drejtë midis të drejtave themelore dhe interesit publik.

7.2. E drejta për dëmshpërblim është e njohur në Kushtetutë, por përcaktimi i mënyrës, kushteve dhe masës është lënë në diskrecion të ligjvënësit.

7.3. Ligji parashikon një mekanizëm të drejtë, të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm financiar, që mbron qytetarët nga arbitrariteti, pa e vënë shtetin përballë një barre të paarsyeshme dhe të paqëndrueshme buxhetore.

7.4. Në raport me vendet e tjera, ligji shqiptar ndjek një logjikë të moderuar në parashikimin e masës, e cila synon të ketë funksion kompensues dhe efekt parandalues. Tavani i vendosur nga ligji nuk cenon thelbin e së drejtës.

8. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1. Gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkimin e saj, pasi nuk ka bërë përpjekje serioze për



të kryer një interpretim shterues të dispozitave të kundërshtuara, ndërsa çështja e referuar ka të bëjë me zgjidhjen legislative të bërë nga Kuvendi, ndaj është jashtë juridiksionit kushtetues.

8.2. Vlerat e përcaktuara të kompensimit nuk bien ndesh me standardet kushtetuese. E drejta e përfitimit të kompensimit nuk është absolute, ajo duhet të ekuilibrohet me interesin publik të përdorimit të arsyeshëm të fondeve publike.

8.3. Ligji parashikon një kufi maksimal të dëmshpërblimit, i cili garanton një kompensim real dhe të arsyeshëm. Ai ruan unitetin dhe parashikueshmërinë në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, stabilitetin buxhetor të shtetit dhe barazinë e individëve që kanë pësuar një dëm të ngjashëm në lloj, që lidhet me privimin e lirisë dhe jo me humbjen e të ardhurave.

8.4. Vlera e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar është plotësisht e krahasueshme me shtete të tjera të rajonit dhe me standardet minimale evropiane, si dhe në përpjesëtim me fuqinë ekonomike të Shqipërisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

9. Nenet 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë se Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur gjyqtarët gjatë gjykimin çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë rast ata nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës.

10. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka zhvilluar kriteret kumulative të legjitimitimit të gjykatës referuese për vënien në lëvizje të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së ligjit, sipas nenit 145 të Kushtetutës dhe nenit 68 të Ligjit Organik të Gjykatës. Sipas këtyre kriterëve, gjatë gjykimin të çështjes, gjykata referuese duhet: i. të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe të vlerësojë se gjykimi i saj varet drejtpërdrejt nga vendimmarrja e Gjykatës, pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; ii. të parashtojë arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e tij, duke iu referuar normave ose parimeve konkrete kushtetuese; iii. të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë*

23.2.2021; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 8, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në lidhje me kriterin e parë, Gjykata rithekson se gjykata referuese duhet të arsyetojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës së kundërshtuar dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes që ajo po shqyrton, duke individualizuar se ajo është norma e zbatueshme në gjykimin pranë saj. Kontrolli incidental vihet në lëvizje vetëm kur gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shprehur Gjykata për kushtetutshmërinë e kësaj dispozite (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 30, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykata referuese po shqyrton padinë e dy shtetasve me objekt kompensimin e paraburgimit të padrejtë të vuajtur gjatë procedimit penal të zhvilluar ndaj tyre (*shih paragrafët 1–3 të vendimit*). E drejta për këtë kompensim rregullohet nga Ligji për Kompensimin e Burgimit, i cili përcakton si kushtet dhe procedurën e përfitimit, ashtu edhe kriteret për llogaritjen e masës së kompensimit. Çështja kushtetuese e parashtruar nga gjykata referuese ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 5, pika 2, dhe 6 të këtij ligji. Konkretisht, neni 5, pika 2, parashikon se kompensimi caktohet deri në 2.000 (dy mijë) lekë për një ditë burgim dhe 3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim, ndërsa neni 6 përcakton se periudha e arrestit në shtëpi kompensohet sipas të njëjtave kriteresh si burgimi, por jo më shumë se gjysma e kompensimit të caktuar për burgimin.

13. Duke pasur parasysh se gjykimi që po zhvillon gjykata referuese ka për objekt ekskluzivisht kompensimin e paraburgimit të padrejtë, Gjykata çmon se lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitës së kundërshtuar dhe zgjidhjes së çështjes ekziston vetëm për togfjalëshin “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, të parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit. Ndërsa pjesa e së njëjtës dispozite që rregullon kompensimin për burgimin, si edhe neni 6, që ka të bëjë me kompensimin e arrestit në shtëpi, nuk gjejnë zbatim në mosmarrëveshjen konkrete dhe, për rrjedhojë, nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e saj. Në këto kushte, gjykata referuese legjitimohet të kërkojë kontrollin kushtetues vetëm për togfjalëshin “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, ndërsa për



pjesën tjetër të dispozitave të kundërshtuara nuk legjitimohet.

14. Në lidhje me kriterin e dytë të legjitimitit, që ka të bëjë me paraqitjen e arsyeve bindëse për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, Gjykata vlerëson se gjykata referuese e përmbush këtë kriter. Ajo ka parashtruar argumente konkrete, sipas të cilave togfjalëshi “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, i parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit, cenon të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim nga paraburgimi i padrejtë, për shkak se masa e kompensimit është në një nivel aq të ulët sa nuk siguron një kompensim efektiv për dëmin e shkaktuar. Këto argumente janë të mjaftueshme për të përmbushur, *prima facie*, kriterin e legjitimitit.

15. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nuk qëndron prapësimi i subjekteve të interesuara, Kuvendi dhe Këshilli të Ministrave, sipas të cilave çështja e referuar lidhet vetëm me një zgjedhje të ligjvënësit dhe, si e tillë, del jashtë juridiksionit kushtetues. Në thelb, gjykata referuese nuk kundërshton thjesht zgjedhjen legislative për përcaktimin e masës së kompensimit, por ngre dyshime për pajtueshmërinë kushtetuese të këtij rregullimi në këndvështrim të efektivitetit të së drejtës për zhdëmtim, pra nëse thelbi i saj është asgjësuar apo jo. Në këtë kuptim, vlerësimi i pajtueshmërisë së kufizimeve të një të drejte themelore me standardet kushtetuese bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

16. Lidhur me kriterin e tretë të legjitimitit, Gjykata rithekson se paraqitja e një kërke për kontroll incidental të kushtetutshmërisë të një norme ligjore përbën një mjet të fundit, të cilit gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet t'i drejtohen vetëm pasi të kenë shteruar mundësitë për ta interpretuar dhe zbatuar normën në përputhje me Kushtetutën. Ky standard buron jo vetëm nga prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, por edhe nga fakti se kontrolli incidental ndikon në kohëzgjatjen e gjykimit dhe, rrjedhimisht, në të drejtat e palëve në procesin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 32, datë 30.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjykata referuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të interpretuar dispozitën ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe vetëm nëse vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me të, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e

kushtetutshmërisë së normës ligjore të identifikuar (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata referuese ka argumentuar se mosmarrëveshja lidhet me vlerën maksimale të kompensimit të përcaktuar shprehimisht nga ligji për një ditë paraburgim të padrejtë dhe se ajo nuk disponon asnjë hapësirë interpretimi ose diskrecioni për të caktuar një masë kompensimi më të lartë se ajo e parashikuar nga ligjvënësi. Në këto kushte, çështja e ngritur nuk mund të zgjidhet nëpërmjet interpretimit të normës në përputhje me Kushtetutën, pasi një interpretim i tillë do të çonte në zëvendësimin e vullnetit të ligjvënësit me atë të gjykatës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se gjykata referuese ka arritur, në mënyrë të arsyetuar, në përfundimin se kontrolli incidental përbënte mjetin e fundit për zgjidhjen e çështjes në përputhje me Kushtetutën, ndaj ajo përmbush edhe kriterin e tretë të legjitimitit.

18. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata çmon se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitit të parashikuara nga neni 145, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 68 i Ligjit Organik të Gjykatës. Për rrjedhojë, ajo do të shqyrtojë në themel nëse togfjalëshi “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, i parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit, bie ndesh me nenin 44 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për zhdëmtim të drejtë

19. Gjykata referuese ka pretenduar se masa e përlllogaritur nuk është në raport të drejtë me dëmin pasuror dhe jopasuror që i shkaktohet individit, ndaj dëmshpërblimi nuk është i plotë dhe i drejtë. Dëmshpërblimi për individin që ka pagë më të lartë se mesatarja asnjëherë nuk është i drejtë, ndërsa mekanizmi i zgjedhur nga shteti shqiptar nuk jep qartësi dhe siguri për dhënien e një kompensimi të plotë. Shpërblimi është pothuajse i papërfillshëm, pasi nuk mbulon as dëmin pasuror dhe as atë jopasuror, duke e lënë individin tërësisht të pambrojtur përballë organeve publike.

20. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se dispozitat e kundërshtuara sigurojnë një standard të mjaftueshëm për mbrojtjen e individit dhe një ekuilibër të drejtë midis të drejtave themelore dhe interesit publik. Ligji parashikon një mekanizëm të drejtë, të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm financiar,



që mbron qytetarët nga arbitrariteti, pa e vënë shtetin përballë një barre të paarsyeshme dhe të paqëndrueshme buxhetore. Në raport me vendet e tjera, ligji shqiptar ndjek një logjikë të moderuar në parashikimin e masës, e cila synon të ketë funksion kompensues dhe efekt parandalues. Tavan i vendosur nga ligji nuk cenon thelbin e së drejtës.

21. Po kështu, subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se vlerat e përcaktuara të kompensimit nuk bien ndesh me standardet kushtetuese. E drejta e përfitimit nuk është absolute, ajo duhet të balancojë interesin e individit me interesin publik të përdorimit të arsyeshëm të fondeve publike. Ligji ruan unitetin dhe parashikueshmërinë në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, stabilitetin buxhetor të shtetit dhe barazinë e subjekteve që kanë pësuar një dëm të ngjashëm në natyrë, që lidhet me privimin e lirisë dhe jo me humbjen e të ardhurave. Vlera e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar është plotësisht e krahasueshme me shtete të tjera të rajonit dhe me standardet minimale evropiane, si dhe në përpjesëtim me fuqinë ekonomike të shtetit shqiptar.

22. Neni 44 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo individit për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim, në përputhje me ligjin, kur është dëmtuar si pasojë e një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore. Ndërsa neni 5, pika 5, i KEDNJ-së parashikon se çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim.

23. Kjo e drejtë themelore shpreh parimin kushtetues se shteti mban përgjegjësi për pasojat e veprimtarisë së tij të paligjshme dhe synon t'i sigurojë mbrojtje efektive individit ndaj cenimit të të drejtave dhe lirive të tij, duke e zhdëmtuar ose rehabilituar atë. Në rastet e kufizimit të padrejtë të lirisë, kjo garanci kushtetuese konkretizohet në të drejtën për kompensim si mjet për riparimin, në masën më të madhe të mundshme, e pasojave të shkaktuara prej tij (kufizimit). Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar rëndësinë e veçantë që merr liria personale si një e drejtë themelore kushtetuese dhe substanciale, si dhe mundësinë që ka kushdo për të gëzuar të drejtën për kompensim kur kufizimi është i padrejtë ose kur ai shkon tej afateve të përcaktuara nga ligji (*shih vendimet nr. 40, datë 17.6.2025; nr. 17, datë 13.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata eidenton se neni 44 i Kushtetutës nuk garanton një shumë të caktuar kompensimi, por të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin. Në këtë kuptim, ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar kushtet, kriteret, procedurat dhe masën e kompensimit. Ky diskrecion, megjithatë, nuk është i pakufizuar. Rregullimi ligjor duhet të respektojë thelbin e garancisë kushtetuese, të mbështetet në kriteret objektive dhe të arsyeshme, të jetë proporcional me qëllimin e synuar dhe të mos e bëjë të drejtën për zhdëmtim iluzore ose joefektive.

25. Gjykata referuese, në mbështetje të argumenteve të saj, i është referuar për analogji jurisprudencës kushtetuese për shpërblimin e drejtë në rastet e shpronësimit. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, megjithëse kompensimi për burgimin e padrejtë dhe shpërblimi për shpronësimin për interes publik kanë natyrë të ndryshme dhe mbrojnë të drejta kushtetuese të ndryshme, të dyja lidhen me kërkesën që masa e kompensimit të mos jetë aq e ulët sa të cenojë vetë thelbin e garancisë kushtetuese. Në jurisprudencën e saj për shpronësimin, Gjykata ka pohuar se një shpërblim dukshëm i pamjaftueshëm mund t'i imponojë individit një barrë joproporcionale dhe, si i tillë, të bjerë ndesh me Kushtetutën. Për këtë arsye, autoritetet kompetente dhe gjykatat duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët përkatës për të arritur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes të të drejtave themelore të individit (*shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Edhe në rastin e kompensimit për burgimin e padrejtë, ndonëse ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për përcaktimin e masës së kompensimit, kjo hapësirë kufizohet nga kërkesa kushtetuese që zhdëmtimi të jetë real dhe efektiv. Në këtë kuptim, edhe në fushën e zbatimit të nenit 44 të Kushtetutës gjejmë zbatim parimet e proporcionalitetit, të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës, të cilat kërkojnë që masa e kompensimit të mos jetë thjesht simbolike ose dukshëm e pamjaftueshme në raport me cenimin e lirisë personale. Për rrjedhojë, këto parime përbëjnë pikë referimi për të vlerësuar nëse rregullimi ligjor siguron një zhdëmtim kushtetues efektiv dhe proporcional për personin që ka vuajtur burgim ose paraburgim të padrejtë.

27. Në të njëjtën linjë, edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut



(GJEDNJ) ka pranuar se gëzimi efektiv i së drejtës për kompensim duhet të garantohet me një shkallë të mjaftueshme sigurie (*shih Ciulla kundër Italisë, datë 22.2.1989, § 44; Sakak dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 26.11.1997, § 60*). Sipas kësaj jurisprudence, e drejta për kompensim e parashikuar në nenin 5, paragrafi 5, të KEDNJ-së përfshin jo vetëm dëmin pasuror, por edhe dëmin jopasuror, si shqetësimin, ankthin dhe vuajtjet psikologjike që individit pëson si pasojë e privimit të paligjshëm të lirisë (*shih Sahakyan kundër Armenisë, datë 10.11.2015, § 29; Teymurazyan kundër Armenisë, datë 15.3.2018, § 76*). Për këtë arsye, një kompensim simbolik ose në raport dukshëm joproporcional me rëndësinë e shkeljes nuk përmbush kërkesat e nenit 5, pika 5, të KEDNJ-së, pasi e bën të drejtën për kompensim teorike dhe iluzore (*shih Vasilevskiy dhe Bogdanov kundër Rusisë, datë 10.7.2018, §§ 22 dhe 26; Cumber kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i Komisionit, datë 27.11.1996*).

28. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka pranuar se përcaktimi i masës së kompensimit për dëmin jopasuror është në vetvete një proces kompleks, pasi nuk ekziston një standard objektiv që të mundësojë matjen në terma monetarë të dhimbjes, vuajtjes, shqetësimit fizik ose ankthit psikologjik të shkaktuar nga kufizimi i padrejtë i lirisë (*shih Firstov kundër Rusisë, datë 20.2.2014, § 35*). Në lidhje me këtë pohim të GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se kjo vështirësi nuk e përjashton detyrimin e shtetit për të siguruar një kompensim që, në rrethanat konkrete, të jetë real, efektiv dhe në përpjesëtim me cenimin e pësuar.

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kuvendi, në bazë të nenit 44 të Kushtetutës, ka miratuar Ligjin për Kompensimin e Burgimit, i cili rregullon rastet e përfitimit dhe masën e kompensimit për periudhën e paraburgimit të padrejtë, mënyrën e llogaritjes, si dhe procedurat për kërkimin, pagesën dhe kompensimin (*neni 1*). Sipas nenit 5 të këtij ligji, kompensimi caktohet nga gjykata, duke mbajtur parasysh: a) të ardhurat nga paga për të punësuarit në sektorin publik ose në sektorin privat, deri një muaj para burgimit; b) fitimin e realizuar nga veprimtaritë tregtare dhe fitimprurëse gjatë tri viteve të fundit para burgimit; c) pensionet e përfituara para ose gjatë paraburgimit; ç) pagën minimale në shkallë vendi për ata që kanë qenë pa punë, të paktën një muaj para datës së burgimit; d) rrethana të tjera, të lidhura me gjendjen

ekonomike e familjare të të burgosurit; dh) të ardhurat nga puna në burg (*pika 1*).

30. Gjykata konstaton se sipas ligjit, kompensimi për paraburgimin e padrejtë përbën një të drejtë me natyrë pasurore, e cila u njihet individëve ndaj të cilëve është zbatuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, por që më pas, me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë deklaruar të pafajshëm ose ndaj të cilëve procedimi penal është pushuar, duke bërë që kufizimi i lirisë në bazë të kësaj mase sigurimi të rezultojë i padrejtë. Në këtë mënyrë, kompensimi synon të riparojë dëmin e pësuar nga individit si pasojë e një akti të paligjshëm të organeve proceduese, konkretisht prokurorit dhe gjykatës, pra të organeve shtetërore, në përputhje me garancinë e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës. Megjithatë, ky kompensim nuk identifikohet me dëmshpërblimin që rrjedh nga përgjegjësia civile jashtëkontraktore. Për këtë arsye, dëmet që kompensohen dhe mënyra e llogaritjes së tyre u nënshtrohen rregullimit të posaçëm të parashikuar në Ligjin për Kompensimin e Burgimit. Brenda hapësirës së vlerësimit që i njeh Kushtetuta, ligjvënësi ka zgjedhur një model të standardizuar kompensimi, i cili synon të garantojë një zhdëmtim real, efektiv dhe proporcional me cenimin e pësuar, duke mbajtur njëkohësisht në konsideratë interesin publik dhe mundësitë financiare të shtetit.

31. Në mbështetje të argumenteve të saj, gjykata referuese ka analizuar se paga minimale në qershor të vitit 2025 ka qenë 40.000 lekë në muaj dhe pritet të rritet në 50.000 lekë brenda vitit 2025, kurse paga mesatare në rang vendi është rreth 90.000 lekë. Pra, sipas saj, vetëm paga mesatare arrin masën maksimale të dëmshpërblimit për arrestin në burg, ndaj kompensimi, duke marrë parasysh se përfshin jo vetëm dëmin pasuror, por edhe atë jopasuror, është shumë i ulët.

32. Përkundër këtyre argumenteve, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se masa e dëmshpërblimit në Shqipëri në raport me pagën mesatare është afërsisht 1.08, ndërkohë që në vende të tjera si Kroacia ky raport është afërsisht 0.56–0.80, ndërsa për Gjermaninë është 0.48, kurse vendi që spikat është Italia, me një masë afërsisht 1.48. Pra, sipas këtij subjekti, Shqipëria ndjek një logjikë të moderuar në parashikimin e masës së dëmshpërblimit. Kurse, subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka evidentuar se paga minimale nga viti 2005 deri në vitin 2024 ka pësuar rritje të



konsiderueshme nga 11.800 lekë në 40.000 lekë, pra vlerat janë në raport të drejtë me zhvillimin ekonomik. Po sipas këtij subjekti, vlera e kompensimit 3.000 lekë për çdo ditë paraburgim llogaritet në total në shumën 90.000 lekë në muaj, pra sa paga mesatare. Po sipas Këshillit të Ministrave, në shumicën e vendeve evropiane, kompensimi është i unifikuar, i ngjashëm me Shqipërinë dhe nuk lidhet me pagën individuale të personit të dëmtuar, por me standardin mesatar të jetesës dhe kapacitetin ekonomik të shtetit, kështu vlera llogaritet për Kosovën me 20 – 30 euro; për Maqedoninë e Veriut me 10 – 30 euro; për Malin e Zi me 20 – 40 euro; për Serbinë me 20 – 50 euro dhe për Bosnjë Hercegovinën me 10 – 30 euro.

33. Në analizë të qëndrimeve të palëve, Gjykata vëren se argumenti kryesor i gjykatës referuese nuk lidhet me zgjedhjen fillestare të ligjvënësit për të caktuar masën e kompensimit në vitin 2005, por me faktin se ajo nuk është indeksuar, pavarësisht zhvlerësimit të monedhës dhe ndryshimeve të ndjeshme të treguesve ekonomikë. Sipas gjykatës referuese, mosrishikimi i vlerës prej 3.000 lekësh për çdo ditë paraburgimi të padrejtë ka sjellë uljen e vlerës reale të kompensimit, duke ngritur dyshime nëse ai vazhdon të përmbushë standardin kushtetues të një zhdëmtimi efektiv dhe proporcional.

34. Mbi bazën e këtij argumenti, çështja kushtetuese nuk konsiston nëse ligjvënësi duhej të zgjidhte një shumë më të lartë kompensimi, por nëse kufiri maksimal prej 3.000 lekësh për një ditë paraburgim është zhvlerësuar në atë masë sa të cenojë thelbin e së drejtës për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata do të vlerësojë nëse rregullimi ligjor i kundërshtuar, në rrethanat konkrete të çështjes, ruan një ekuilibër të drejtë ndërmjet hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit dhe thelbit të së drejtës kushtetuese për zhdëmtim. Me fjalë të tjera, kontrolli kushtetues do t'i japë përgjigje pyetjes nëse mekanizmi i kompensimit vazhdon të sigurojë një zhdëmtim real dhe proporcional për dëmin e shkaktuar nga kufizimi i padrejtë i lirisë.

35. Fillimisht, Gjykata vëren se vlerat monetare të parashikuara në Ligjin për Kompensimin e Burgimit nuk kanë pësuar ndryshime që nga miratimi i tij në vitin 2005. Megjithatë, kjo situatë nuk është karakteristike vetëm për këtë ligj. Edhe dispozita të tjera me rëndësi në legjislacionin penal,

si ato të KP-së që rregullojnë vlerat e gjobës ose zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënimin me burgim, gjithashtu nuk kanë qenë objekt i një rishikimi të përgjithshëm të vlerave monetare në pikëpamje të indeksimit. Kështu, neni 34 i KP-së ka parashikuar masat e dënimit me gjobë për kundërvajtjet dhe krimet, ku vlera minimale prej 50 mijë dhe vlera maksimale prej 10 milionë lekë kanë mbetur të pandryshuara nga viti 2001. Po nga i njëjti vit ka mbetur i pandryshuar edhe zëvendësimi i gjobës me burgim, duke u llogaritur 5 mijë lekë për një ditë burgim. Në analizë të këtij treguesi, Gjykata vlerëson se, si rregull, kur ligji parashikon të drejta ose detyrime të shprehura në shuma monetare fikse, me qëllim ruajtjen e efektivitetit të të drejtave themelore, ligjvënësi duhet të vlerësojë periodikisht nevojën për rishikimin e tyre, në mënyrë që ato të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike të vendit, përfshirë inflacionin, fuqinë blerëse të monedhës dhe tregues të tjerë ekonomikë relevantë. Një rishikim i tillë kontribuon në ruajtjen e efektivitetit të rregullimeve ligjore dhe në realizimin e qëllimit për të cilin ato janë miratuar.

36. Në vijim, Gjykata thekson se vetëm fakti që dispozitat e Ligjit për Kompensimin e Burgimit nuk kanë pësuar ndryshime që nga miratimi i tyre nuk mjafton, në vetvete, për të arritur në përfundimin se ato bien ndesh me Kushtetutën. Edhe në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se, në parim, vjetrimi i normës nuk përbën *per se* shkak për antikushtetutshmërinë e saj, përveçse në rastin kur ajo nuk i përgjigjet zhvillimit social, kulturor, ekonomik dhe moral të shoqërisë në atë masë që nuk respekton thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut (*shih vendimin nr. 69, datë 27.12.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në këtë drejtim, argumenti i gjykatës referuese, sipas të cilit masa e kompensimit është zhvlerësuar për shkak të ndryshimeve të treguesve ekonomikë, nuk gjen mbështetje në rrethanat konkrete të çështjes. Analiza e saj është bazuar në treguesit ekonomikë të vitit 2025, ndërkohë që paraburgimi për të cilin kërkohet kompensimi është vuajtur në vitin 2018. Për rrjedhojë, proporcionaliteti i masës së kompensimit duhet të vlerësohet në raport me realitetin ekonomik të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim dhe jo mbi bazën e treguesve të një periudhe disa vite më të vonë. Në vlerësimin e Gjykatës, treguesit ekonomikë të vitit 2018 nuk rezultojnë të kenë



pësuar ndryshime të tilla, në raport me periudhën e miratimit të ligjit, sa të çojnë në përfundimin se kufiri maksimal prej 3.000 (tre mijë) lekësh për një ditë paraburgim e ka humbur funksionin e tij kushtetues. Për ilustrim, në vitin 2005, paga minimale ishte 11.800 lekë (*shih VKM-në nr. 460, datë 23.6.2005*), ndërsa në vitin 2018 ishte 24.000 lekë (*shih VKM-në nr. 399, datë 3.5.2017*). Duke mbajtur në konsideratë edhe modelet krahasuese të referuara nga subjektet e interesuara, Gjykata vëren se kompensimi nuk synon të zëvendësojë të ardhurat individuale të personit të dëmtuar, por të garantojë një zhdëmtim të standardizuar dhe proporcional për cenimin e lirisë personale. Për rrjedhojë, përcaktimi nga ligjvënësi i një kufiri maksimal kompensimi nuk është, në vetvete, antikushtetues, për sa kohë ai ruan një raport të arsyeshëm me qëllimin e ligjit dhe nuk e bën të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim teorike ose iluzore.

38. Gjykata konstaton se shumica prej 3.000 (tre mijë) lekësh nuk përbën një shumë fikse kompensimi, por kufirin maksimal që mund të caktohet nga gjykata. Ligji parashikon një mekanizëm që lejon individualizimin e masës së kompensimit në varësi të rrethanave konkrete të secilit rast, me synimin për të mbuluar dëmin e shkaktuar nga kufizimi i padrejtë i lirisë. Në këtë proces, barra e provës për rrethanat që justifikojnë masën e kompensimit i takon kërkuesit. Për rrjedhojë, kushtetutshmëria e dispozitës nuk mund të vlerësohet mbi bazën e rasteve hipotetike ose të supozimit se kompensimi mund të rezultojë i pamjaftueshëm për individë me të ardhura veçanërisht të larta. Në çështjen konkrete, gjykata referuese nuk ka parashtruar ndonjë rrethanë të tillë në lidhje me paditësit. Për sa më sipër, Gjykata çmon se togfjalëshi **“3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”**, i parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit, nuk bie ndesh me nenin 44 të Kushtetutës, ndaj pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e gjykatës referuese është e pabazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577,

datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.6.2026.

Shpallur më 8.7. 2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi

VENDIM

Nr. 72, datë 16.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;

me sekretare Anjeza Puka, në datën 16.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (Z) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Zymer Martinaj, Diana Martinaj, të përfaqësuar nga avokatët Konstandin Tradafli dhe Sakip Lata, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Ministria e Mbrojtjes, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Aleks Marku.

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Komanda e Forcës Ajrore, përfaqësuar komandanti, gjeneralmajor Ferdinand Dima.

SHOQËRIA “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., në mungesë.



OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 540, datë 13.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 347, datë 23.6.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-3457, datë 11.9.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, shkronja “P”, 134, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, Zymer Martinaj dhe Diana Martinaj (*kërkuësit*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandës së Forcës Ajrore, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a. (*shoqëria e sigurimit*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit janë bashkëshortë dhe trashëgimtarë ligjorë të djalit të tyre, i cili ka humbur jetën në moshën 22-vjeçare, më 27.2.2011, në vendin e quajtur “Fusha e Aviacionit Ushtarak”, në fshatin Gjadër, Lezhë. Sipas rrethanave të ngjarjes, ai drejtonte një motomjet dhe u përplas me një automjet.

2. Automjeti i përfshirë në ngjarje ishte në pronësi të drejtuesit dhe ishte i siguruar pranë subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimit, ndërsa vendi në të cilin ka ndodhur aksidenti ishte dhe vazhdon të jetë nën administrimin e subjektit tjetër të interesuar, Komandës së Përgjithshme Ushtarakë.

3. Të nesërmen e ngjarjes, më 28.2.2011, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë (*Prokuroria e*

Lezhës) ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të drejtuesit të automjetit për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafi i parë, i Kodit Penal. Gjatë hetimeve paraprake është kryer një ekspertim autoteknik, sipas të cilit ngjarja nuk kishte ndodhur në rrugë automobilistike dhe të pajisur me sinjalistikë. Mbi bazën e këtij akti, prokurori ka konkluduar se drejtuesi i automjetit nuk kishte konsumuar elementet e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, ndaj në datën 22.4.2011, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

4. Në këto rrethana, më 5.4.2013, kërkuësit kanë ngritur padi civile, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së sigurimit për shpërblimin e dëmit në shumën 4.660.343 lekë, si dhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandës së Forcës Ajrore për shpërblimin e dëmit në shumën 11.277.546 lekë. Gjatë gjykimit gjykata ka caktuar një ekspert, akti i ekspertimit të të cilit ka përcaktuar se vlera totale e dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar nga kërkuësit si pasojë e humbjes së jetës së djalit të tyre arrinte në shumën 15.937.889 lekë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 540, datë 13.10.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ajo ka arsyetuar se e drejta për dëmshpërblim ndaj shoqërisë së sigurimit ishte parashikuar, pasi padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dyvjeçar, ndërsa kërkimin ndaj Komandës së Forcës Ajrore nuk mbështetej në ligj, për shkak se nuk ishte provuar se vdekja e viktimës kishte ardhur si pasojë e veprimeve me faj të këtij institucioni. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur apel.

5. Gjatë gjykimit në apel kërkuësit kanë hequr dorë nga kërkimin i tyre ndaj shoqërisë së sigurimit, duke kërkuar që padia të vazhdonte vetëm ndaj Komandës së Forcës Ajrore dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Me vendimin nr. 347, datë 23.6.2016, Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo ka vënë në dukje se, megjithëse gjykimi në apel ishte ndërprerë për kërkimin ndaj shoqërisë së sigurimit, si pasojë e heqjes dorë nga padia, ky kërkim, ndryshe nga sa kishte arsyetuar gjykata e shkallës së parë, ishte paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar, pasi ky afat fillonte të rridhte nga data e pushimit të procedimit penal dhe jo nga data e aksidentit. Nga ana tjetër, lidhur me kërkimin për shpërblimin e dëmit ndaj Komandës së Forcës Ajrore dhe Ministrisë së



Mbrojtjes, gjykata e apelit ka arsyetuar se, sikurse ishte konkluduar edhe në vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal, ngjarja ishte rast fatkeq dhe nuk provoheshin elementet e përgjegjësisë civile, konkretisht kundërligjshmëria e sjelljes, lidhja shkakësore dhe faji.

6. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3457, datë 11.9.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve, me arsyetimin se shkaqet e ngritura nuk bazoheshin në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Në datën 10.10.2025, kërkuësi i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual. Kolegji i Gjykatës, në datën 29.12.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Kërkuësi*, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

8.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1.1 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi rekursi është paraqitur në datën 21.7.2016, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar atë duke zbatuar kriteret procedurale të miratuara me ndryshimet ligjore që kishin hyrë në fuqi në muajin gusht 2017 dhe jo ato që ishin në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit. Si pasojë e këtij interpretimi është cenuar edhe e drejta e aksesit në aspektin substancial, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar të gjitha shkaqet e rekursit.

8.1.2 *E drejta e aksesit*, pasi rekursi është vlerësuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, ndërkohë që kompleksiteti i çështjes, kohëzgjatja e procesit prej rreth 13 vjetësh, si dhe fakti se në rekurs ngriheshin çështje të interpretimit të ligjit dhe mosrespektimit të praktikës gjyqësore nga gjykatat e faktit, impononin shqyrtimin e tij në seancë gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë u ka mohuar atyre edhe të drejtën për të paraqitur dhe mbrojtur efektivisht pretendimet e ngritura në rekurs.

8.1.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e ngritura prej tyre në

rekurs. Ajo gjykatë nuk ka dhënë asnjë argument se përse ka vlerësuar se vendimet e gjykatave të faktit nuk ishin në shkelje të ligjit material dhe atij procedural, si dhe të praktikës gjyqësore.

8.2 *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuësi, në bazë të rregullave ligjore të përgjegjësisë jashtëkontraktore, gëzonin pritshmëri të ligjshme për të përfutur dëmshpërblim nga shkaktarët e dëmit. Gjykatat e zakonshme ua kanë mohuar këtë të drejtë, duke i privuar nga përfitimi i një të drejte pasurore.

8.3 *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuësi janë trajtuar ndryshe nga palët në raste të ngjashme, në të cilat gjykatat kanë konstatuar përgjegjësinë e subjekteve kur me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë lejuar krijimin e rrethanave që kanë sjellë dëm. Në rastin e tyre, organet publike nuk kanë marrë masat e nevojshme për mbylljen ose sigurimin e hyrjes kryesore të fushës së aviacionit në Gjadër, duke lejuar aksesin e lirë të personave në një zonë, që përdorej edhe për gara automobilistike. Fusha nuk ishte e pajisur me punonjës sigurie, sinjalistikë ose masa të tjera parandaluese. Masat për kufizimin e aksesit janë marrë vetëm pas ndodhjes së aksidentit.

9. *Subjektet e interesuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Komanda e Forcës Ajrore*, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar mbi të njëjtat argumente se kërkuësi nuk legjitimohen *ratione materiae*, pasi pretendimet e tyre lidhen, në thelb, me interpretimin e ligjit dhe analizën e fakteve, për rrjedhojë:

9.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e gjykatës së caktuar me ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen sipas parashikimeve ligjore dhe nuk rezulton të ketë marrë ose administruar prova të reja. Gjykata e Lartë, në përputhje me ligjin procedural të zbatueshëm, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se ai nuk përmbushte kërkesat ligjore për të vënë në lëvizje funksionin e saj rishikues. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk kishte detyrimin të jepte një arsyetim të detajuar për themelin e çështjes, por vetëm të shpjegonte shkaqet e mospranimit të rekursit.

9.2 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit nuk qëndron. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë arritur në një



përfundim të ndryshëm nga ai i kërkuar prej tyre për ekzistencën e përgjegjësisë jashtëkontraktore të Ministrisë së Mbrojtjes nuk përbën, në vetvete, trajtim të pabarabartë në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës. Gjykatat kanë vlerësuar se në rrethanat konkrete nuk provohej lidhja shkakësore ndërmjet veprimit ose mosveprimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe dëmit të pësuar, duke çmuar se ajo nuk kishte një detyrim konkret ligjor, mosrespektimi i të cilit të sillte përgjegjësinë e saj civile.

10. *Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitimit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *shterimi i mjeteve juridike* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

13. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata ka pohuar se detyrimi i njoftimit të vendimit të arsyetuar u takon gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 69, datë 6.11.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur individ i ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit, atëherë momenti i

konstatimit të cenimit konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar i njoftohet atij elektronikisht.

14. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 11.9.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare në datën 29.10.2024. Kërkesit kanë parashtruar se, ndonëse në prapësimet e depozituara pranë Gjykatës së Lartë kishin shënuar adresën e postës elektronike për komunikimin e vendimit, ai nuk u ishte njoftuar individualisht. Për këtë arsye, në datën 16.4.2025, nëpërmjet avokatit të tyre, ata i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për vënien në dispozicion të vendimit. Me shkresën e datës 23.4.2025, Gjykata e Lartë i ka bërë me dije avokatit të kërkesësve se veprimet administrative kishin përfunduar dhe se fashikulli gjyqësor ishte dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Më pas, në datën 30.5.2025, avokati i kërkesësve i është drejtuar asaj gjykate, e cila, me shkresën e datës 18.6.2025, i ka vënë në dispozicion kopje të akteve të fashikullit gjyqësor, përfshirë edhe vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë. Pas marrjes së këtij vendimi, kërkesit kanë paraqitur ankimin kushtetues individual në datën 10.10.2025.

15. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkesit kanë treguar dilijencën e duhur për t’u njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, duke ndërmarrë veprime konkrete për sigurimin e tij, pasi ai nuk u ishte njoftuar individualisht. Për rrjedhojë, në kushtet e mungesës së një njoftimi të tillë, afati ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual fillon të llogaritet nga momenti kur kërkesit kanë marrë dijeni efektive për përmbajtjen e vendimit të arsyetuar. Për sa kohë ankimi kushtetues është paraqitur në datën 10.10.2025, pra brenda 4 muajve nga data 18.6.2025, Gjykata çmon se ai është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj kërkesit legjitimohen *ratione temporis*.

16. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* (në aspektet e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor), *së drejtës së pronës*, si dhe *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 41 dhe 18 të Kushtetutës. Ndërsa subjektet e interesuara kanë prapësuar se pretendimet e kërkesësve lidhen, në thelb, me interpretimin e ligjit dhe analizën e fakteve, ndaj ata nuk legjitimohen *ratione materiae*.



17. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuessit kanë parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar dispozitat procedurale në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit, që parashikonin kritere më të gjera për pranimin e rekursit (*shih paragrafin 8.1.1, të vendimit*). Subjektet e interesuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Forcës Ajrore, kanë prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar drejt dispozitat procedurale.

18. Gjykata vëren se ky pretendim, në thelb, ka të bëjë me zbatimin në kohë të dispozitave procedurale. Në jurisprudencën e saj ajo ka theksuar se, ndryshe nga e drejta materiale, në të drejtën procedurale vepron parimi *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri zbatohet edhe për çështjet që janë në gjykim, përveç rasteve kur vetë ligji parashikon ndryshe (*shih vendimet nr. 30, datë 2.5.2025; nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Përfshirjet nga ky parim përcaktohen shprehimisht në dispozitat kalimtare, me të cilat ligjvënësi, brenda hapësirës së tij të vlerësimit, ka çmuar se disa rrethana imponojnë një zgjidhje të ndryshme.

19. Në rastin konkret, dispozitat kalimtare të ligjeve nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021 kanë parashikuar se kriteret e pranueshmërisë së rekursit vlerësohen sipas dispozitave të KPC-së në fuqi në kohën e depozitimit të tij. Në të njëjtën linjë, edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se dispozita e zbatueshme për vlerësimin e pranueshmërisë së rekursit ishte neni 472 i KPC-së, sipas formulimit që ka pasur përpara ndryshimeve me ligjet nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021 (*shih paragrafët 15–16, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë zbatuar një regjim procedural të ndryshëm nga ai i parashikuar nga ligji, ndaj pretendimi i kërkuessve për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është haptazi i pabazuar.

20. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, kërkuessit kanë parashtruar, ndër të tjera, se, për shkak të kompleksitetit të çështjes, kohëzgjatjes prej 13 vjetësh të procedurave gjyqësore dhe natyrës së pretendimeve të ngritura në rekurs, çështja duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit. Sipas tyre, kjo mënyrë shqyrtimi u ka

mohuar të drejtën për t'u mbrojtur (*shih paragrafin 8.1.2 të vendimit*).

21. Gjykata çmon se edhe këto argumente janë haptazi të pabazuara. *Së pari*, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuessit. *Së dyti*, fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, mbi bazën e akteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar. Përkundrazi, në këto raste debati gjyqësor zhvillohet nëpërmjet paraqitjes dhe shkëmbimit, në kohën e duhur, të argumenteve me shkrim (*shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). *Së treti*, kërkuessit kanë qenë të përfaqësuar gjatë gjithë procesit nga avokatë të zgjedhur prej tyre, ndaj e drejta e mbrojtjes u është garantuar në mënyrë efektive.

22. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, kërkuessit kanë parashtruar se, ndryshe nga raste të ngjashme, gjykatat nuk kanë njohur përgjegjësinë e organeve publike për dëmin e pësuar (*shih paragrafin 8.3 të vendimit*).

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti. Vetë fakti që në një çështje tjetër është arritur në një zgjidhje të ndryshme nuk mjafton për të provuar cenimin e parimit të barazisë, pasi çdo çështje paraqet veçoritë e saj faktike dhe provuese (*shih vendimet nr. 47, datë 11.6.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard, Gjykata çmon se në rastin konkret vendimet e referuara nga kërkuessit nuk janë të mjaftueshme, ndaj ky pretendim nuk qëndron.

24. Gjithashtu, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, duke argumentuar se ai nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm për rrëzimin e pretendimeve të tyre lidhur me zbatimin e ligjit material, procedural dhe praktikës gjyqësore (*shih paragrafin 8.1.3 të vendimit*). Po kështu, ata kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së pronës*, për shkak të mosnjohjes të së drejtës për dëmshpërblim (*shih paragrafin 8.2. të vendimit*).

25. Gjykata, mbështetur në thelbin e pretendimeve të kërkuessve dhe në zbatim të parimit *iura novit curia*, vlerëson se, ndonëse ata kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës për shkak të mosnjohjes së dëmshpërblimit, në thelb,



çështja lidhet me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, jeta e personit mbrohet me ligj, çka i ngarkon shtetit detyrimin, së pari, për të krijuar një kuadër ligjor të përshtatshëm për mbrojtjen e saj dhe, së dyti, për të siguruar që organet kompetente, përfshirë gjykatat, të verifikojnë nëse institucionet publike kanë përmbushur detyrimet që burojnë prej këtij kuadri (*shih vendimin nr. 10, datë 13.3.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në rastet kur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit ka ardhur si pasojë e neglizhencës së autoriteteve shtetërore, shteti ka detyrimin të ndërmarrë masa efektive për të sqaruar rrethanat e ngjarjes, për të identifikuar përgjegjësit dhe për të siguruar dëmshpërblimin e përshtatshëm për viktimën ose familjarët e saj (*shih vendimin nr. 55, datë 6.5.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat, në kundërshtim me detyrimet pozitive që burojnë nga neni 21 i Kushtetutës, nuk kanë njohur përgjegjësinë e organeve publike për dëmin e pësuar dhe, si rrjedhojë, u kanë mohuar dëmshpërblimin e kërkuar. Për këtë arsye, ndryshe nga sa prapësojnë subjektet e interesuara, Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione materiae*. Nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve, Gjykata do t'i shqyrtojë ato në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës në drejtëm të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

27. Kërkuesit kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm, pasi nuk shpjegon arsyet për të cilat janë rrëzuar pretendimet e ngritura në rekurs lidhur me zbatimin e ligjit material, procedural dhe praktikës gjyqësore. Sipas tyre, gjykatat e zakonshme nuk kanë vlerësuar drejt përgjegjësinë e organeve publike, të cilat nuk kishin marrë masat e nevojshme për mbylljen ose sigurimin e hyrjes në fushën e aviacionit në Gjadër, duke lejuar aksesin e lirë të personave në një zonë të mbrojtur që përdorej edhe për gara automobilistike. Ata kanë theksuar se fusha nuk ishte e pajisur me punonjës sigurie, sinjalistikë ose masa të tjera parandaluese dhe se masa të tilla u morën vetëm pas ndodhjes së aksidentit.

28. Subjektet e interesuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Forcës Ajrore, kanë prapësuar se

Gjykata e Lartë ka zbatuar drejt ligjin kur ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ai nuk përmbushte kërkesat formale të parashikuara nga ligji dhe, për rrjedhojë, nuk ishte i aftë të vinte në lëvizje funksionin rishikues të saj, ndaj nuk ekziston detyrimi për një arsyetim të detajuar. Gjithashtu, ato kanë pretenduar se nuk është provuar lidhja shkakësore ndërmjet veprimit ose mosveprimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe dëmit të pësuar, ndërsa gjykatat kanë vlerësuar drejt se ky organ nuk kishte një detyrim konkret ligjor për të marrë masat e pretenduara nga kërkuesit.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë garanton mbrojtjen efektive të individit ndaj çdo cenimi të të drejtave të tij, përfshirë ato që vijnë nga veprimet ose mosveprimet e administratës shtetërore, nëpërmjet një kontrolli gjyqësor efektiv të pavarur dhe të paanshëm (*shih vendimet nr. 55, datë 6.5.2026; nr. 10, datë 13.3.2025; nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë nuk kufizohet vetëm në mundësinë për të vënë në lëvizje gjykatën, por përfshin edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimit është element thelbësor i një procesi të rregullt ligjor, pasi u tregon palëve se pretendimet e tyre janë dëgjuar, u mundëson atyre ta kundërshtojnë vendimin dhe evidenton faktet e provuara dhe ligjin e zbatueshëm mbi të cilët gjykata ka mbështetur zgjidhjen e mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 12, datë 18.3.2025; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 20, datë 13.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky standard nuk nënkupton se gjykata duhet t'i përgjigjet në mënyrë të detajuar çdo pretendimi të palëve, pasi shkalla e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin kushtetues të arsyetimit. Megjithatë, kur në rekurs ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, ka detyrimin t'i shqyrtojë ato dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 31, datë*



2.5.2025; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese).

31. Në dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimet e të tria shkallëve të gjykimit. Gjykatat e faktit e kanë rrëzuar padinë e tyre, duke arsyetuar se pretendimet ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandës së Forcës Ajrore mbetën të paprovuara, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin e kufizuar se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji. Në këto rrethana dhe në respekt të kufijve ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe atij të gjykatave të zakonshme, Gjykata do të shqyrtojë nëse përgjigja që kërkuesit kanë marrë nga gjykatat e zakonshme ndaj pretendimeve të tyre përmbush standardet kushtetuese të aksesit substancial në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

32. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se në datën 27.2.2011, djali i kërkuesve ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti, i shkaktuar nga përplasja ndërmjet mjetit që ai drejtonte dhe një automjeti të drejtuar nga një person tjetër. Aksidenti ka ndodhur në pistën e avionëve të aeroportit ushtarak të Gjadrit në Lezhë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka hetuar çështjen vetëm në drejtim të përgjegjësisë penale të drejtuesit të automjetit për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Me vendimin e datës 22.4.2011, prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se aksidenti nuk kishte ndodhur në rrugë dhe, për rrjedhojë, nuk përmbusheshin elementet e kësaj vepre penale. Ndonëse në këtë vendim është konstatuar se ngjarja përbënte një rast fatkeq, nuk janë parashtruar arsyet dhe as analiza e provave ose e veprimeve hetimore mbi të cilat mbështetej ky përfundim.

33. Në datën 5.4.2013, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga humbja e jetës së djalit të tyre. Ata kanë pretenduar se në ardhjen e pasojës së rëndë kishin kontribuar edhe dy subjektet e interesuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Forcës Ajrore, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme për ruajtjen dhe administrimin e zonës ushtarake ku ka ndodhur aksidenti. Sipas kërkuesve, këto subjekte mbanin përgjegjësi solidare, pasi ushtronin autoritetin ligjor mbi pistën e avionëve të aeroportit ushtarak.

34. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Komanda e Forcës Ajrore, me shkresën e datës 13.6.2014, ka informuar Ministrinë e Mbrojtjes se: a) fusha e aviacionit Gjadër ishte në administrimin e saj dhe e përfshirë në Planin e Vendosijes dhe Përhapjes së Forcës Ajrore, të miratuar me dekretin nr. 7459, datë 11.5.2012, të Presidentit të Republikës; b) kishte aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë për pajisjen me certifikatën e pronësisë (aplikimi i datës 29.7.2004), por ende nuk ishte pajisur me të. Ndërkohë, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, me shkresën e datës 22.9.2014, ka njoftuar Ministrinë e Mbrojtjes se: a) sipas vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar (VKM-ja nr. 515/2003), prona objekt verifikimi ishte evidentuar me nr. 983, me emërtimin “Reparti Ushtarak 4010”, me vendndodhje në Gjadër, Lezhë; b) kjo pronë, në datën 27.2.2011, nuk ishte përfshirë në Planin e Vendosijes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me dekretin nr. 983, datë 9.12.2009, të Presidentit të Republikës. Po kështu, me shkresën e datës 26.7.2013, Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) ka konfirmuar se pista e aerodromit Gjadër është pronë e Ministrisë së Mbrojtjes, në administrim të Komandës së Forcës Ajrore, ndërsa përdorimi i saj është në kompetencë të Ministrisë së Mbrojtjes.

35. Sipas prapësimeve të Komandës së Forcës Ajrore, të paraqitura gjatë gjykimit, prona ku ka ndodhur aksidenti, me emërtimin “Fusha e Aviacionit Gjadër”, sipas VKM-së nr. 515/2003, përfshihet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo listë përbëhet nga 1.117 prona dhe për asnjërën prej tyre Këshilli i Ministrave nuk ka ngarkuar me përgjegjësi administrimi Komandën e Forcës Ajrore. Sipas këtij institucioni, ai ushtron veprimtarinë e tij vetëm në një pjesë të këtyre pronave, të përfshira në planin e përhapjes të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës, por përgjegjësia administrative mbi to mbetet në çdo rast e Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu, komanda ka pretenduar se, edhe nëse do të pranohej se përgjegjësia administrative i takonte asaj, kjo përgjegjësi do të lindte vetëm pas përfshirjes së



pronës në planin e përhapjes, e cila ka ndodhur me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 11.5.2012, pra më shumë se një vit pas aksidentit.

36. Ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka sqaruar se fusha e aerodromit Gjadër është pronë shtetërore në administrim të Komandës së Forcës Ajrore, e cila administron edhe përdorimin e pistës. Sipas saj, kjo rrethanë provohej nga shkresa e Komandës së Forcës Ajrore e datës 13.6.2014, aplikimi pranë hipotekës për pajisjen me certifikatën e pronësisë, shkresa e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e datës 22.9.2014, si dhe shkresa e ANTA-s e datës 26.7.2013. Për rrjedhojë, ka prapësuar ministria, për ngjarjen e vitit 2011 legjitimim pasiv kishte Komanda e Forcës Ajrore si autoriteti administrues i pronës, ndaj ajo duhej të përjashtohej nga gjykimi.

37. Gjithashtu, gjatë gjykimit në shkallë të parë është administruar akti i vlerësimit të dëmit shëndetësor, i përgatitur nga eksperti vlerësues, sipas të cilit aksidenti ka ndodhur në fushën e aviacionit ushtarak në Gjadër të Lezhës, pronë e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nuk ishte ruajtur nga pronari i saj. Sipas ekspertit, enti pronar duhej të kishte marrë masat e nevojshme për të mos lejuar hyrjen e mjeteve civile të paaautorizuara në zonën ushtarake, duke vendosur sinjalistikën përkatëse, në përputhje me nenet 14 dhe 37 të Kodit Rrugor, si dhe duke garantuar sigurinë e qarkullimit brenda kësaj zone (*shih faqen 2 të aktit të ekspertimit*). Po kështu, sipas konkluzioneve të aktit të ekspertimit autoteknik të Policisë Rrugore, të datës 9.3.2011 (i administruar gjatë hetimeve), rezulton se ngjarja automobilistike ka ndodhur në një pistë avionësh të braktisur me një hapësirë të gjerë që tejkalon përmasat e çdo karrexhate të parashikuar nga Kodi Rrugor dhe që nuk ishte e pajisur me asnjë shenjë të sinjalistikës rrugore. Në të njëjtën kohë, eksperti ka vlerësuar se drejtuesit e mjeteve ndodheshin në një vend të paaautorizuar për qarkullim dhe të papërcaktuar për zhvillimin e garave automobilistike, konkretisht në pistën e aviacionit ushtarak (*shih faqen 4 të aktit të ekspertimit*).

38. Në përfundim të gjykimit, me vendimin e datës 13.10.2014, gjykata e shkallës së parë ka analizuar zbatimin e neneve 608 dhe 625 të Kodit Civil ndaj Komandës së Forcës Ajrore. Ajo ka vlerësuar se përgjegjësia jashtëkontraktore ekziston vetëm nëse provohen në mënyrë kumulative: i. dëmi; ii. veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm;

iii. lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes antiligjore dhe dëmit; iv. faji në formën e dashjes ose të pakujdesisë.

39. Në zbatim të këtyre kriterëve, gjykata ka çmuar se kërkuesit kishin provuar ekzistencën e dëmit, përkatësisht humbjen e jetës së djalit të tyre dhe pasojat pasurore e jopasurore që rridhnin prej saj, por nuk kishin arritur të provonin elementet e tjera të përgjegjësisë jashtëkontraktore. Sipas saj, mungonin prova që të vërtetonin se autoritetet shtetërore, me dashje ose nga pakujdesia, kishin kryer mosveprime të kundërligjshme që kishin shkaktuar aksidentin dhe pasojën fatale. Për rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar se nuk kishte asnjë provë mbi bazën e së cilës të mund të arsyetohej në mënyrë bindëse se aksidenti kishte ardhur si rezultat i mosveprimeve antiligjore të Komandës së Forcës Ajrore. Në mbështetje të këtij përfundimi, ajo i është referuar edhe hetimit penal të zhvilluar nga prokuroria, duke arsyetuar se nëse Komanda e Forcës Ajrore do të kishte qenë shkaktare e aksidentit, do të ishte regjistruar procedim penal ndaj personave përgjegjës (*shih faqen 7, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*).

40. Ky arsyetim është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin e saj të datës 23.6.2016. Ajo ka argumentuar se për lindjen e përgjegjësisë civile nuk mjafton vetëm ekzistenca e dëmit, kundërligjshmëria e sjelljes dhe lidhja shkakësore ndërmjet tyre, por duhet të provohet edhe faji i autorit të dëmit. Në rastin konkret, sipas saj, nuk ishte provuar se Komanda e Forcës Ajrore ose Ministria e Mbrojtjes, me dashje ose nga pakujdesia, kishte kryer mosveprime antiligjore që kishin sjellë aksidentin dhe vdekjen e viktimës. Për këtë përfundim, Gjykata e Apelit i është referuar edhe vendimit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal, i cili e kishte klasifikuar ngjarjen si rast fatkeq (*shih faqet 7–8, të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

41. Nga ana e saj, Gjykata e Lartë, me një arsyetim të kufizuar, të përmbledhur në pesë paragrafë, ka vlerësuar se nuk rezultonin shkelje të ligjit procedural ose material që të bënin të pavlefshëm procesin gjyqësor ose të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave.

42. Duke qenë se pretendimet e kërkuesve lidhen me mosveprimet e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për administrimin e fushës së ish-aviacionit ushtarak, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në kuadrin ligjor që rregullon këtë përgjegjësi. Ligji



nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, parashikon se zonat, instalimet dhe objektet e destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare përbëjnë pronë të paluajtshme publike të shtetit (*neni 3, pika 1, shkronja “c”*). Sipas këtij ligji, organi përgjegjës ka detyrimin ta administrojë këtë pronë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Kodin Civil, duke garantuar mbrojtjen e saj, ruajtjen e interesit publik dhe ushtrimin efektiv të përgjegjësisë të ngarkuara (*nenet 11–14*). Në zbatim të këtij kuadri, Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat ushtarake janë autoritetet përgjegjëse për administrimin e pronave të paluajtshme të mbrojtjes, përgjegjësi e konfirmuar edhe nga legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre. Për rrjedhojë, administrimi i këtyre pronave nuk përbën vetëm një kompetencë, por edhe një detyrim ligjor për garantimin e sigurisë së tyre dhe parandalimin e rreziqeve që burojnë nga mosadministrimi.

43. Gjykata, në analizë të sa më sipër, konstaton se gjykatat e faktit e kanë reduktuar shqyrtimin e çështjes në një vlerësim formal të elementeve të përgjegjësisë jashtëkontraktore, duke arsyetuar se nuk ishte provuar që autoritetet shtetërore, me dashje ose nga pakujdesia, të kishin kryer veprime ose mosveprime të kundërligjshme që kishin shkaktuar vdekjen e viktimës. Megjithatë, ato nuk kanë analizuar paraprakisht nëse ngjarja, e cila kishte sjellë humbjen e jetës së viktimës, lidhej me cenimin e së drejtës kushtetuese të jetës dhe sigurisë së personit, si dhe me natyrën dhe përmbajtjen e detyrimeve ligjore që buronin nga administrimi i një prone publike me destinacion ushtarak, të vlerësuara në këndvështrimin e detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës. Po kështu, ato nuk kanë verifikuar nëse përmbushja e këtyre detyrimeve kërkonte marrjen e masave për ruajtjen, kontrollin dhe kufizimin e aksesit në territorin ku ndodhi aksidenti. Në këto kushte, vlerësimi i tyre për mungesën e kundërligjshmërisë, fajit dhe lidhjes shkakësore nuk rezulton të jetë mbështetur mbi një analizë të plotë të rrethanave vendimtare të çështjes dhe të shpërndarjes së barrës së provës ndërmjet palëve.

44. Gjykata vëren, gjithashtu, se gjykatat e zakonshme i kanë dhënë rëndësi faktit se prokuroria e kishte cilësuar ngjarjen si rast fatkeq dhe se nuk kishte regjistruar procedim penal ndaj autoriteteve shtetërore përgjegjëse për administrimin e territorit

ku ndodhi aksidenti. Në këtë mënyrë, përfundimet e procedimit penal janë marrë në konsideratë në gjykimin civil pa u verifikuar nëse dhe në çfarë mase ato kishin lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e mosmarrëveshjes civile. Kjo është e rëndësishme, pasi procedimi penal kishte për objekt vetëm përgjegjësinë penale të drejtuesit të automjetit dhe jo përgjegjësinë civile të autoriteteve shtetërore për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore në lidhje me administrimin, ruajtjen dhe kontrollin e territorit ku ndodhi aksidenti. Megjithatë, gjykatat nuk kanë arsyetuar se çfarë rëndësie kishte mungesa e një procedimi penal ndaj këtyre autoriteteve për vlerësimin e përgjegjësisë së tyre civile.

45. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se gjykatat nuk kanë verifikuar nëse autoritetet shtetërore përgjegjëse kishin marrë masa konkrete dhe të përshtatshme për kufizimin e hyrjes, mbikëqyrjen dhe garantimin e sigurisë së territorit nën administrimin e tyre. Kjo mangësi bëhet edhe më e dukshme po të mbahet parasysh se, sipas akteve të ekspertimit, aksidenti kishte ndodhur në një zonë të paautorizuar për qarkullimin e mjeteve motorike dhe për zhvillimin e garave automobilistike, ndërsa kërkuesit kishin pretenduar se masat për mbylljen e hyrjeve dhe kufizimin e aksesit në atë zonë ishin marrë vetëm pas ndodhjes së aksidentit. Këto rrethana kishin rëndësi për vlerësimin e pretendimit të kërkuesve se autoritetet publike nuk kishin përmbushur detyrimet ligjore për administrimin, ruajtjen dhe garantimin e sigurisë së territorit ku ndodhi aksidenti. Megjithatë, gjykatat nuk rezulton t'i kenë shqyrtuar ato në funksion të sqarimit të natyrës dhe përmbajtjes së detyrimeve konkrete të autoriteteve publike, si dhe të vlerësimit të pretendimit të kërkuesve për përgjegjësinë civile të këtyre autoriteteve. Për rrjedhojë, ato nuk u kanë dhënë kërkuesve një përgjigje të mjaftueshme për çështje që lidheshin me thelbin e mosmarrëveshjes.

46. Për pasojë, arsyetimi i gjykatave të faktit mbetet i pamjaftueshëm, pasi ato nuk kanë sqaruar rrethanat vendimtare të çështjes, konkretisht statusin juridik të zonës ku ndodhi aksidenti, autoritetin përgjegjës për administrimin e saj, natyrën e masave që kërkoheshin për kontrollin, ruajtjen dhe kufizimin e hyrjes në atë territor, si dhe masat që rezultonin të ishin marrë realisht përpara aksidentit. Në këtë kuptim, në mungesë të sqarimit të këtyre rrethanave, pretendimi i kërkuesve se autoritetet shtetërore nuk kishin përmbushur



detyrimet ligjore që u ngarkonte kuadri normativ në fuqi ka mbetur pa një përgjigje të mjaftueshme nga gjykatat e faktit.

47. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se marrëdhëniet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm udhëhiqen nga parimi i subsidiaritetit. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në rastin konkret, mangësitë në arsyetimin e gjykatave të faktit, të cilat lidheshin me thelbin e pretendimit të kërkuar për përgjegjësinë civile të autoriteteve publike, përbënin çështje që kërkonin vlerësim nga Gjykata e Lartë në kuadër të funksionit të saj rishikues. Ky vlerësim nuk kërkonte zëvendësimin e gjykatave të faktit në çmuarjen e provave, por kontrollin nëse arsyetimi i tyre, në raport me detyrimet ligjore të autoriteteve publike dhe shpërndarjen e barrës së provës, u kishte dhënë kërkuarve një përgjigje efektive ndaj pretendimit të ngritur në rekurs. Megjithatë, duke vendosur mospranimin e rekursit me arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur ndaj këtyre çështjeve. Për rrjedhojë, si gjykatë e ligjit, ajo nuk ka përmbushur detyrimin për t'u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuarve. Këto pretendime lidheshin me mënyrën sesi gjykatat e faktit kishin interpretuar dhe zbatuar rregullat e përgjegjësisë jashtëkontraktore, pa shqyrtuar mjaftueshëm nëse autoritetet publike kishin përmbushur detyrimet ligjore për administrimin, ruajtjen dhe kontrollin e territorit ku ndodhi aksidenti, në këndvështrimin e së drejtës

kushtetuese për mbrojtjen e jetës dhe të detyrimeve pozitive të shtetit që burojnë nga kjo e drejtë. Për këtë arsye, vendimmarrja e saj nuk përmbush standardet kushtetuese të aksesit substancial në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

49. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin e kërkuarve është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3457, datë 11.9.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.6.2026.

Shpallur më 8.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 151][Datë: 14.07.2026 13:48:29
+02:00][d87600a5-4834-4cbe-a736-e62f03f8aa2d
Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)